



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 113, Mars 2013

Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Unë jam ringjallja
dhe jeta; ai që
beson në mua, edhe
sikur të duhej të
vdesë do të jetojë

GËZUAR PASHKËT

A DO TË KEMI DEPUTET DUKAGJINAS?

Nga LUIGJ SHYTI

Përmes fjalimesh, britmash, sharjesh, shpifjesh, presionesh, mburrjesh e super premtimeve po kalojnë ditët e dita e votimeve po afron. Por a do të kemi zgjidhje, sepse votime mund të bëhen dhe zgjidhje mund të mos kenë. A do të kemi zgjidhje për zgjedhje apo zgjedhje për zgjidhje, a do të zgjidhet ai që e meriton, ai që na përfaqëson, ai që di dhe do të përfaqësojë interesin e shumicën, pa lënë në harresë edhe pakicën, që njihet dhe publikon hallet tona, hallet e komunitetit, apo do të zgjidhet ai që kërkon të bëhet deputet, ai që ka para, që investon materialisht që sapo të ulet në karrigen e deputetit harrojnë për problemet që ka parë dhe do të kërkojnë në kohën e fushatës dhe do të kërkojnë vetëm kur të afrohet fushata e ardhshme.



KARDINALËT
NA "DHUROJNË"
PAPËN E RI

PRELË GRIMAJ
- NDERI I
KOMUNËS SHALË

6

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi
Botimin:
NDUE
FTONI



A DO TË KEMI DEPUTET DUKAGJINAS?



Nga **LUIGJ SHYTI**

Përmes fjalimesh, britmesh, sharjesh, shpifjesh, presionesh, mburrjesh e super premtimeve po kalojnë ditët e dita e votimeve po afron. Por a do të kemi zgjidhje, sepse votime mund të bëhen dhe zgjidhje mund të mos kenë. A do të kemi zgjedhje për zgjedhje apo zgjedhje për zgjidhje, a do të zgjidhet ai që e meriton, ai që na përfaqëson, ai që di dhe do të përfaqësojë interesin e shumicën, pa lënë në harresë edhe pakicën, që njih dhe publikon hallet tona, hallet e komunitetit, apo do të zgjidhet ai që kërkon të bëhet deputet, ai që ka para, që investon materialisht që sapo të ulet në karrigen e deputetit harron për problemet që ka parë dhe dëgjuar në kohën e fushatës dhe do të kujtohet vetëm kur të afrohet fushata e ardhshme.

Është mjaft evident fenomeni që vendet e rëndësishme, karrigen e deputetit, apo ministrit, të drejtorit, apo titullarëve të tjerë ta zëna ata që duan dhe jo ata duhet, pra ata që i bëjnë llogaritë në tavolinë e jo ata që njohin gjithë problematikën e shtresave popullore. Në një miting një folës, politikan, i "tund" parat kameramanëve apo gazetarëve kur kërkon që të flasë më shumë se sa është koha e parashikuar, duke u thënë "paguaj unë" për kohën që po merrte. Po, dakord more zotëri ti paguan sepse ke para, ti je njeri zyresh, politikan që dëshiron të marrësh poste, tu japësh të tjerëve mend, të vinë të tjerët pas teje, po ai qytetari që mbase ka mend më shumë se ti, por që ka para më pak se ti, kur do t'i dëgjohet zëri; po ai fshatari nga Malet e Dukagjinit apo Mali i Gramozit, nga Fusha e Myzeqesë, apo nga rrëza e Korabit, si do ta thotë mendimin e tij, kërkesën e tij, për problemet që ka apo

i dalin përpara, për mollët që i kalben, për mungesën e rrugës automobilistike, për mungesat në arsim dhe shëndetësi, për perimet që nuk del dot në treg për ti shikuar sepse ka konkurrencë të pandershme, e te tjera e te tjera, apo duhet të përdoret ajo shprehja e bukur "na e thuaj ne se ja thojmë na", që do të thotë se duhet të ta thonë ty, ti tua thuash të tjerëve, e këta dikujt tjetër, hallkë pas hallke, në vend të ta thotë vetë direkt, pa ndërmjetës.

Në votimet drejt të cilave po shkojmë, përfaqësohen shumë parti nga më të ndryshmet, me emra të bukur, me iniciale të bukura, me flamurë shumëngjyrësh (mbase edhe me shumë flamurë, jo vetëm të shpalosur por edhe në xhep), por se ku i kanë anëtarët nuk merret vesh. Shikohen dhe dëgjojnë lider, apo politikan të tjerë, që gjithmonë përdorin vetëm përemrin vetor "unë" dhe atë pronor "imja" dhe kurrsesi nuk përdorin përemrin vetor "ne" dhe as atë pronor "jonë". Bëhen mitingje dhe gjithkund ka shumë njerëz. Gjithsej vendi ynë ka rreth 3 milion banorë, që banojnë në Shqipëri, si atëherë gjithsecila parti ka kaq shumë simpatizant. Po të bëjmë një llogari të thjeshtë del se një partie në Shqipëri, i bie mesatarisht të kenë jo më anëtar partie, por banorë 23 000-24 000 persona, që nga fëmijët e sapo lindur deri te më të moshuarit. Kur vjen puna për votues llogaritë dalin shumë ultë.

Këto votime, si edhe të gjitha të tjerët, janë edhe për malësorët dukagjinas, me të mirat dhe dobësitë e tyre.

A ka komuniteti dukagjinas përfaqësues të mundshëm, a meriton ky komunitet që të kenë përfaqësuesin e vet në Parlamentin Shqiptar? Dihet se, përfaqësuesit nuk janë vetëm për një zonë, apo krahinë. Ata do të diskutojnë probleme të shumta dhe për të gjitha zonat, por kur është një shpërndarje e mirë, kur përfaqësohen të gjitha shtresat e popullsisë në rrafshin vertikal, por edhe në atë horizontal ka më shumë besim, problemet shtrohen dhe zgjidhen edhe me mirë edhe më shpejt.

Ndodhë jo radhë që për par-

titë shtyhem me njeri-tjetrin, shikohemi me inat, a nuk jemi me afër me njeri-tjetrin se sa me partitë?! Me partitë nuk kemi lidhje gjaku, me njeri-tjetrin po. Me partitë nuk lidhim krushqi apo kumbari, ose të paktën nuk duhet të kemi të tilla lidhje, me njeri-tjetrin po, sepse nga një anë ose nga një tjetër jemi të lidhur, të gjithë dalim shumë më të afërm me njëri-tjetrin se sa partitë.

Unë nuk e di, prandaj, nuk mund të them "ja ku është", "ja ku bëhet shitblerja e votës", por rëndomtë flitet për një gjë të tillë. Një gjë e di se "ku është me zë nuk është pa gjë". Vota e shitur nuk ka asnjë vlerë për atë që e shet përveç, ndoshta, 2 000 lekëve, një gjysmë thesi me miell ose një thes me "zhele". Vota në këtë rast shkon atje ku nuk duhet, tek ai që nuk e meriton, edhe ai që e blenë e di se nuk e meriton. Për këtë votë, ti që e shite, nuk ke asnjë të drejtë që ti kërkojë llogari ati që ta ka blerë, të kërkojë zgjidhjen e kërkesave tua, sepse vjen një moment që të thotë "për votën që më ke dhënë të kam paguar" dhe nuk mund të kundërshtosh, sepse kështu ja ke bërë vetë shërbimin. Edhe për atë që e blen nuk vlerë me përfshim të përfitimeve personale, sepse ai që blen votën nuk e ka mendjen për të punuar. Ata që blejnë votën me lekë, apo me plaçka të ndryshme, së pari mendojnë të kompensojnë shpenzimet, por edhe ti rrisë me shumicë. Mbase ky është edhe qëllimi kryesor i këmbënguljes së tyre për të fituar. Shitblerja e votës është një veprim i kundërligjshëm dhe i kundërmoralshëm. Shikohen të zgjedhur që ndryshojnë karrigen për një arsye apo një tjetër. Është e lejueshme nga Kushtetuta, pra nuk përbën shkelje ligjore. Por, një gjë nuk është e arsyeshme dhe as e moralshme, nuk duhet të ndërrohen bindjet për karrigen, por karrigeje për bindjet.

Ka plotë raste, në mos rëndomtë, që nuk dëgjojnë mendimet, problemet, titullarët nuk duan që të ngrihen probleme, zyrtarët nuk kanë veshë për të dëgjuar, nuk kanë sy për të parë, bëjnë shurdhin dhe qorrin. Këto fillojnë sapo fito-

hen votat, dhe kujtohen kur të vijjnë votimet e radhës.

Nuk janë të pakta rastet që angazhimi, politizimi, tifozëria politike gjatë fushatave shkon shumë thellë në ndërgjegjen e njerëzve. A nuk është dhënie e tepërt pas politikës, pas votës sa kur vdes njeriu dhe njoftohet i afërmi i tij që të mund të merrte pjesë dhe për të ndihmuar në ceremoninë mortore shprehet, pa ndrojtje, se jam me votime e gati sa nuk thotë "pse ka vdekur në këtë kohë", ndryshohet data e dasmës, ndërpriten ceremoni që janë të radha dhe të paracaktuara. Këto ose si këto janë raste të vërejtura, konkrete, gjatë periudhës së fushatave zgjedhore sa që mbeten në mendje për shumë kohë. Ky është tejpolitizim!

Unë mendoj pa ndrojtje se, na duhet dhe kemi mundësi, që komuniteti dukagjinas të përfaqësohet në Parlamentin Shqiptar. Kemi djem dhe vajza, gra e burra me arsim dhe kulturë, intelektual të mirëfilltë me grada e tituj shkencorë, që flasim më shumë se një gjuhë të huaj, shkrimtarë e poet, mjekë dhe ushtarakë të rangjeve të larta, agronom, juristë dhe ekonomistë, specialistë dhe mjeshtër në fusha të ndryshme, kemi inxhinier të zotët, të cilët njohin problemet, interesat dhe kërkesat e komunitetit tonë, pra njohin në detaje punën, jetën, zhvillimin, mangësitë dhe perspektivën e zonës. Kemi njerëz dashamirës, bashkëpunues, që duan përparimin, të vendosur për realizimin e kërkesave të komunitetit, idealistë në punën e tyre më shumë se sa materialist. Për këto që thash jam i sigurt, por një gjë tjetër nuk e di, nëse kanë para apo jo. Po që se, duhen para edhe për postin e politikanit, postin e te zgjedhurit, kjo nuk më duket aspak e drejtë dhe në fakt nuk është e drejtë, sepse kështu do të mbetet në pushtet gjithnjë vetëm ata që kanë para, të cilët pleqërojnë gjithnjë ata që nuk kanë ose kanë pak para.

Për të pasur deputet ka dy elemente me rëndësi: Së pari, partitë duhet të mendojnë për një shtrirje sa më përfaqësuese. Në këtë rast nuk duhet të rrinë duarkryq dhe në pritje me gojëhapur anëtarët dhe simpatizantët e partive, veçanërisht ata të partive të mëdha që të bëhet e mundur vendosja në listat e partive në zonën e mundshme për të fituar, sepse po të vendoset diku nga fundi,

sa për ta vendosur, apo edhe plus numrit maksimal të mundshëm, nuk ja vlen. Kjo duhet të dëgjohet nga lidërsipit.

Së dyti: Që të arrihet një fitore duhet pjesëmarrja në votime, vlerësimi i çdo vote dhe votimi për atë listë, atë Parti apo koalicion që ka vendosur më afër mundësinë e fitores së kandidatit që duam dhe duhet të duam atë bashkëkrahinarin tonë. Kjo vlen në radhë të parë për dy partitë e mëdha që kanë mundësi që të futin më shumë deputet në parlament.

Duke bërë një llogari të thjeshtë për komunitetin dukagjinas në Qarkun e Shkodër, del plotësisht e mundur që të mund të dalë fitues edhe më shumë se një deputet. Në se duan që ta kenë gojën hapur dhe të drejtën për tu kërkuar votën komunitetit dukagjinas kudo që janë në këtë qark, partitë duhet të vendosin në listat e tyre intelektual edhe nga Dukagjini.

Edhe në zgjedhje që kanë kaluar kemi pasur mundësi që të kishim deputet nga komuniteti dukagjinas, por nuk u arrit sepse nuk qe bashkëpunimi midis kandidatëve për ti hapur rrugë njëri tjetrit, megjithëse u është kërkuar shoqërisht për të organizuar dhe mundësuar krijimin e mundësive të bashkëpunimit midis tyre, me qëllim që të mund të fitonte dikush e jo të humbisnin të gjithë. Po të vlerësojmë dhe veprimet bashkërisht do të kemi shumë mundësi që të kemi deputet dukagjinas, mbase edhe më shumë se një. Për këtë, Partitë, sidomos PS dhe PD, duhet të vlerësojnë me shumë kujdes këtë komunitet, ti japin mundësinë, sepse edhe ato nuk do të zhgënjehen.

Dukagjini dhe dukagjinasit duhet vlerësuar për atë që i kanë dhënë pa rezerva Shqipërisë, zhvillimit të vendit dhe demokracisë, në të gjitha kohërat, por, që kanë marrë aq pak, që janë shpërblyer aq pak në të gjitha kohërat.

Me votën e komunitetit tonë, me votën tonë të ndershme dhe të drejtë, të pavarur dhe me dinjitet mund dhe duhet të kemi deputet dukagjinas në parlamentin e ardhshëm.

A duhet të kemi deputet nga komuniteti ynë? PO! A mund të kemi? PO! A do të kemi? Këtë nuk e di, por e uroj me gjithë zemër një gjë të tillë.

KARDINALËT NA "DHUROJNË" PAPËN E RI

Me 13 mars 2013, 115 Kardinalë, të mbledhur në Kapelën Sistine, të zbukuruar me afresket e mrekullueshme të Mikelanxhelos, zgjodhën Papa Françesku (latinisht: Franciscus; i lindur Jorge Mario Bergoglio; më 17 dhjetor 1936). Ky Papë është 266-ti i Kishës Katolike. Në këtë rol, ai është edhe udhëheqësi i Kishës Katolike dhe sovran i qytetit të Vatikanit.

Nga viti 1998 dhe deri në zgjedhjen e tij si Papë, ai shërbeu si Arqipeshkëv i Buenos Aires-it dhe u bë kardinal në vitin 2001 nga Papa Gjon Pali II.

Përveç gjuhës amtare, spanjishtes, Françesku flet rrjedhshëm italisht dhe gjermanisht.

Françesku është i pari jezuit dhe i pari amerikan-lat-in që zgjidhet Papë. Ai është gjithashtu Papa i parë jo-europian në 1200 vite.

Papa i ri ka jetuar në një apartament të thjeshtë dhe për të lëvizur ka përdorur gjithmonë transportin publik. Kur është zgjedhur kardinal, ai ka detyruar bashkëkombasit e tij, të cilët ishin organizuar për të marrë pjesë në ceremoni në Romë, të qëndrojnë atje dhe paratë e mbledhura t'i jepnin për të varfërit.

Është tifoz i ekipit të San

Lorenzos, një nga skuadrat e kryeqytetit argjentinas.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Barack Obama i dërgoi "urimet më të ngrohta" në emër të popullit amerikan Papës së sapozgjedhur, duke lavdëruar argjentinasin si "të parin Papë nga kontinentit amerikan". Presidentja e Argjentinës, Christina Fernandez de Kirchner, i

uroi atij një "mision të frytshëm pastoral". Kryeministri britanik, David Cameron, tha se kjo ishte një "ditë e rëndësishme për katolikët; ndërsa kryepeshkopi i Canterbury-t, Justin Welby, lider i Anglikanëve të botës, i ofroi atij "bekimin e tij". "Pres ta takoj Papa Françeskun dhe të ecim e punojmë së bashku, për të vazhduar më tej trashëgiminë e qëndrueshme të parardhësve tanë", tha ai në një njoftim. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-moon, tha se pret me padurim për të bashkëpunuar me të, falë "lidhshimit të menjëhershëm" të Papës Françesku.

Rreth 1 milion njerëz janë mbledhur

në Vatikan për të marrë pjesë në inaugurimin e Papa Françeskut. Liderit politikë dhe fetarë nga e gjithë bota morën pjesë në meshën në Sheshin e Shën Pjetrit, që simbolizon kështu nisjen e detyrës së re për Papën e ri.

Sipas BBC, Papa do të vazhdojë një praktikë para Pashkëve të larjeve të këmbëve, që e ka aplikuar kur ishte kryepeshkop në Buenos Aires. Larja e këmbëve të enjten përpara Pashkëve është një traditë e krishterë që daton që prej kohërave të Krishtit. Gjatë këtij shërbimi, Papa lan dhe puth këmbët e 12 njerëzve, për të riprodhuar gjestin e përlules së Krishtit përpara 12 apostujve të tij natën përpara se të kryqëzohej.

Edhe Shqipëria ka kontribuar në papatin më shumë se 2000 vjeçarë. Një papë shqiptarë, tashmë, i njohur dhe pranuar ishte Papa Klementi XI, Gjon Françesk Albani i cili u lind në Urbino (Itali) me 23 korrik 1649. Me 9 tetor 1700 filloi detyrën e Papës. Papa Klementi XI - Albani vdiq me 19 mars 1721 mbasi e udhëhoqi kishën katolike për 21 vjet rrjesht dhe rreshtohet i katërti për nga vitet në krye të Kishës Katolike mbas Shën Pjetrit me 35 vjet, Papa Pio IX me 31 vjet, Papa Gjon Pali me 26 vjet.

Familja Albani e kishte prejardhjen nga familja fisnike e Mikel Laçit, nga Laçi i Kurbinit.

Nga **LUIGJ MILA**



Vertetë, kush janë malësoret?



Nga **RUSH DRAGU**

Përgjigja e kësaj pyetje është aq e vjetër sa edhe vetë historia e atyre trojeve.

Do të përpiqem të sqaroj diçka se, kush janë malësoret?

U ndjeva mirë, kurë në ambientet e restorantit të kishës së "Shën Palit" u diskutua një shkrim që AlbDreams kishte botuar nga gazetari Pergega.

Ai, si gazetar tashmë është i njohur për temat e "buta" dhe superlativat që përdorë për ngjarjen, vendet dhe personazhet, por kësaj here më shumë se, sa më parë "tharmi" i fjalëve të tij kishte mpiks mirë tek subjekti që i ishte drejtuar.

Megjithëse stilistika e Zefit na "konfliktin" shpesh më njëri-tjetrin, kësaj here

mbeta "viktima" e "çarkut të mirditorit" dhe i bëra publicitet shkruimit të Zefit duke qenë "kritiku" i butësisë së shkrimeve të tij.

E thashë edhe më lart se, ti përgjigjesh pyetjes se, "Vërtetë, kush janë malësoret?", donë volume të tëra. Dua të prekë disa që në pamjen e jashtme janë të thjeshta, por kanë vlera madhore dhe "tinëzishit" shpesh heshtën e shpërdorohen.

Në Michigan është komuniteti më i vjetër, më i madh dhe më i konsoliduar. Të shumtit vinë nga Hoti, Gruda, Trieshi, Koja e Luhari, që janë nën sundimin e Malit të Zi, dhe si thotë kënga e një malësori: "... pesëqind vjet me turk dhe njëqind vjet me shkja ...", ata, kanë ruajt gjuhën dhe zakonet e mira si askush tjetër, e si as një krahinë e rrezikuar nga këta pushtues.

Jo vetëm mosha e dytë dhe e tretë e malësorëve e flet shqipen, por edhe fëmijët e tyre, që kanë lindur dhe rritë në Amerike e të shumtët nuk e kanë shkelë Malësinë e flasin si të kishin mbërritë tash nga Shqipëria, gjuhën e bukur shqipe.

A nuk është vërtetë kjo një vlerë e padiskutueshme e malësorëve?

Janë djem dhe vajza që kanë lindur në Amerikë dhe sot kanë grupet e tyre

muzikore, që na gëzojnë më këngët e bukura shqipe, dasmat, festat dhe ditët e mërgimit tonë. Ata janë lindë, rritë dhe arsimuar në shkollat amerikane, por gjuhën e bekuar të stërgjyshërve të tyre e flasin bukur dhe me dëshirë.

Malësorit i ka "qeshë balli" kur miku ja behu te pragu i shtëpisë. E ketë virtut me shumë vlerë e kanë edhe malësoret e Amerikës.

Kush u ka ra te dera për ndihme e ata nuk e kanë nise me "peshqesh" aq sa kanë pas mundësitë?! Rri shtrembër dhe fol drejt se, bujarinë malësoret e Amerikës nuk e kanë harruar.

Eh, si është jeta?!

A është vlerësuar gjithmonë ai që e meriton? Pa diskutim, që asnjëherë dhe në çdo vend ka hileqarë dhe spekulant.

Malësori dhe Malësia, kurrë nuk e dhanë mikpritjen për ofiqe dhe grada, pasi ai ka ndihmuar nevojtarin e ka pritë mikun jo se ka qenë "i paditur" dhe mund ta mashtrosh lehte, por e ka dhënë, për hatër të Zotit, tek i cili nuk e ka humbë kurrë besimin, për se ai e ka pas traditë te heshtur në shpirt dhe e ka njohtë me shumë se kushdo tjetër nevojën për ndihmë.

Vendi, armiqtë që e kanë rrethuar e kanë bërë ta vlerësoj si askush tjetër "nevojën e tjetrit!"

Hileqaret, që edhe nuk kanë qenë të paket, e kanë marrë si "dobësi" pa thënë për "budallallëk", dorëdhënien, mikpritjen, bukën e mirë, buzëqeshjen e grave dhe vajzave malësore, kur miku në shtëpi është i pritur nga i zoti i saj.

Nuk është se, duhet përmendë ndera që bën, kushdo ofhtë, por kurë ai tjetri ka nevojë çdo herë të kurrë nuk është kthyer mbrapsht e "duarbosh" nga "shtëpia" e malësorit, a duhet dhe ai ta thotë një faleminderit nga zemra!? Mendoj unë, e si unë shumë të tjerë se, Po!

Po kështu e paska jeta!

Hilja paska lindë bashkë me njerëzimin! Jo vetëm, malësoret nuk u vlerësuan për punët e shumta dhe me vlera nacionale, që i kanë dhënë këtij komuniteti, por tinëzishit duan ta anashkalojnë historinë e shkëlqyer të tyre, të bëjnë se është harruar, e pse jo të përfitojnë në mënyrë djallëzore; karrige në krye të vendit, dekorata, e pse jo edhe përmendore!?

Nuk them se, malësori nuk e "ka vu" mikun në krye të vendit dhe ka lënë vetin keq e atë e ka pritë si mos më mirë, por nuk janë të gjithë Gjergj Fishtë dhe Edith Durham, të cilët malësoret i kishin "lule në kapuç".

Vërtetë kush janë malësoret?

Kohët e reja, domosdoshmërisht edhe për ta lypur, që ta duam më tepër vetin se, atëherë "nevojtarët" do ta vlerësojnë më shumë bujarinë e tyre.

Shqiponja kuq e zi dykrenare që shendriti Romën



Nga Prof. LULASH NIKË PALUSHAJ

Sytë e botës njerëzore ndaj diçkaje që nuk ndodh shpesh, por të rikthen në brezëni historie të së kaluemes dhe me mendjen elektronike natyrore të njeriut me shumë shpejtësi përmes ekraneve televizive ma prestigjioze në botë si, CNN në konglomeratin e tij të paraqitjeve nga Sheshi i Shen Pjetrit të Romës, të sjell në mendje veprime të shumë ngjarjeve. Në mesin e shumë fl-amujve të nacionaliteteve botënore valonte falmuri ma i bukur në botë, Kuq e Zi, me at' Shqiponjë Dykrenare, e mbajtur nga dora e një shqiptari, që i kishte thanë zemra me e çue naltë shqiponjën shqiptare, historinë e vërtetë të Gjergj Kastriotit, i cili në dhjetor të vitit 1466, kishte shkue me një përfaqësi të vetën në këtë qytet të shumë ngjarjeve për të dëshmuar se, gjaku shqiptar dhe i këtij nacionaliteti asht heroik në mbrojtje kundër sllavëve dhe Perandorisë Osmane. Janë Roma dhe Konstantinopoli –Stambolli me shumë histori të shkrueme dhe të përfoluna, por edhe me shumë qartësi në rrjedha historike, sidomos ndaj botës shqiptare e me shumë mistere, që ne nuk i dimë, por dashtë e padashtë nëpër plejada dhe dekada e shekuj me sundime të sunduesëve që ka përjetue shumë mjerime e masakrime nacionaali shqiptarë dhe shkaktue ikjen e mija e mija njerëzve; e milionave të këtij nacionaliteti që nga ekzistenca e deri sot janë dhimbje, lot e gjak i derdhun dhe ata çka asht edhe ma e kobëshme gjithënjë tue mbrojtë tokat e veta etnike dhe kërkoi liri e vetëvendosje pa të keqe të askujt, por në baze të drejtave, që i takojnë një populli.

Flamuri shqiptarë në Sheshin e Romës u duk si meteor nga dora e atij shqiptari, që rrjeti televiziv i CNN i mori përballë flamurit të Shteteve të Bashkueme të Amerikës dhe valonte me aq krenari e madhësi dhe mendja të shkon menjihërë në shumë ngjarje të së kaluemes dhe të sotmes dhe skanë mbarim. Nji tym që delte nga kumini i shumëpritun i miljarde njerëzve, të atij tymi në të bardhë, shenjë se u zgjodh Papa i ri me detyrë shekujsh. E në synin e asaj të pritune me mendje të përqendrueme tek flamujt që valojshin të mija e mija njerëzve në këtë shesh, kishte hap krahët shqiponja shqiptare me dorën e atij që vetes i thotë vetëm shqiptar dhe dëshmoi se me gjithë lashtësinë që ky popull ka, asht flamur i parë në Evropë dhe vendin e kishim dhe e kemi gjithmonë aty. E atherë mendja dhe gëzimi të çon me mendue se shqiptaria dhe shqiptarët sot kanë miq të dëshmuemë po dijtme me i ruejtë.

Amerika me shtete aleate bombardoi Beogradin e at' Serbi, vetëm për punë të shqiptarëve e Kosovës nga masakrat e përjetueme nga ky sundues nëpër shekuj. Flamuri shqiptar, ai yll vezullues qiellor në Sheshin e Shen

Pjetrit të Romës, gjaku dhe historia e simboli i asaj shqipe që bashkon gjith shqiptarët kudo janë, përveç ngjarjes që pritej të kryhej me rastin e Papës së posazgjedhun, mendja më shkoi se derisa ishte Papa Gjon Pali i II, edhe në vazhdim, aty shkuan personalitetet e njohuna shqiptare ma parë dhe sot. Tue pa dhe dëshmue se bota shqiptare i dha fëtyra të randësishme Evropës dhe botës, ndër ata edhe bija shqiptare Nënë Tereza, sepse si të dësh ta marrim, por shqiptaria nga çdo sundues nëpër shekuj nga sllavë, grekë, osmane-turke, masakra e shpartallime përjetoi. Ai burrë-burri e patriot i madh legjendar Isa Boletini me flamur e kobure i shkoi Londrës me u dhanë me kuptue se ka Shqipni dhe shqiptarët duhet të jenë të pamvarun dhe në tokat e përbashkëta etnike të jetojnë. Patrioti i madh, shkrimtari dhe dietari, publicisti dhe humanisti, themeluesi i alfabetit të gjuhës shqipe, shqipes evropjane, cieceroni dhe homeri i shqiptarëve At' Gjergj Fishta me "Lahutën e Malcisë", e sa të tjerave; kudo veptoi e vrapoi me zemër shpirt e fjalë e flloi vetëm për shqiptarë dhe fjalën e zemër Shqipni se "... edhe në vorr me t'përmend kam". I mësoi si duhet gjaku, gjuha, ditunia e kultura dhe çka asht ma e madhja, para së gjithash, si duhet atdheu dhe çlirimi nga sunduesit e zgjedha e tyne. Po ai, Noli dhe Konica, që me flamurin shqiptar i qitën kushtimin me vepra dhe fjalë Vilsonit të Amerikës për ta shpëtue at' Shqipni e mos ta zhdukim nga faqja e dheut prej shteteve fqinje dhe përkrahësit e tyne. Po sa Rilindës të tjerë në krye me vëllaznit Frashër e at' Naim të ambël dhe të bekuemë,

O burra shqiptarë, motra fisënike shqiptare! Le të mendojmë për gjakun e dëshmorëve ma shpesh, ma me përkushtim, ma me përkujtim, ma me dëvotshmëni, ma me zemër e shpirt për gjakun e gjuhën tande, se bota shqiptare duhet nderuar.

E di se, pa miq nuk mundet dhe gjithmonë nevoiten për zhvillimin dhe progresin njerëzorë, marrëdhanye e diplomaci, kulturë e qytetnim, por askush nuk mund ta shpëtojë e zhvillojë shqiptarinë përveç shqiptarëve. Edhe Papa, që asht kulminanta e simbolit dhe lirisë shpirtnore për të drejta që vet Zoti i jep njeriut si krijesë e shfaq nacionalitetin e vet. Na gjithëmonë kemi fjalë të drejta dhe të vërteta në histori se Prizreni dhe Ulpiana ishin të princave Dukagjinë me Pal e Lekë Dukagjinin. si thonë e vërtetueme edhe me Kanunin si "Ka thanë Leka", "Je i lirë me mbajtë burrninë tande, je i lirë me u zhburrënue". Ne ende nuk jemi ngi as kënaq si popuull i lirë me shqiptari as me vetëve. Çdo ditë e ma shumë, nëse e vërejmë me mish e shpirt e me zemër dhe në emnin e gjakut shqiptarë të derdhun për tokë e gjuhë shqiptare, shumëherë gabojmë e flasim për të huejat e të huejtë që skanë lidhje me ne, as me traditë çka asht shqiptare. Flasi me madhësi për sunduesit që na kanë shkatrrue; mundohemi ti rikthejmë me pa meritë në histori ata që i vranë shqiptarët dhe fatosat e tyne, i çuenë në vorre që shumicës as nuk u dihen se ku janë ... nuk u përmbahemi fjalëve që i kanë përjetue dhe dëshmue për historinë e së vërtetës shqiptare gjyshat e stërgjyshat tanë të përbashkët që vet vorret flasin. Para gjakut e gjuhës nuk



De Radën e arbëreshëve e qinda e qinda të tjerë para tyne, në kohën e tyne e deri në ditët tona, të qinda mija emigrantëve me at' Shqiponjë dykrenare të gjakut të shqiptarve, të Gjergj Kastriotit, tue marshue e kërkue liri e drejtësi dhe bashkimin e shqiptarëve në kufinin natural etnik para Nacionaliteteve të Bashkueme në Njujork, Vashington, Bruksel, Vjenë, Londër, Romë e kudo tjetër për ta dëshmue se, ka Shqipni dhe ka shqiptarë se, ka Kosovë vetëm me shqiptarë dhe se kjo Shqipni asht përrreth gjithkund e rrethue me shqiptarë, të coptuemë prej hapësines etnik Shqipni. Në lapidarin ma të naltë monumental duhet të ngriten demonstratat dhe kërkesat e studentëve në Prishtinë dhe atyne ma vonë në Tiranë.

mundesh me vu asnjisend tjetër. E dëshmue-në me fjalë e gjak të derdhun me qinda e mija e miliona shqiptarë se te Zoti shqiptarë jemi dhe të flasi shqip në atdheun ku e kemi.

A ka mallkime nëse na nuk i përmbahemi gjakut e gjuhës sone dhe atij gjaku të derdhun për liri? Nama as mallkimi nuk i bjen asnjë njeriu që asht në të vërtetë. Edhe shqiptarëve dita e bardhë u ka ardhë. Namës e mallkimit ti ruhen ata që i thonë vetit shqiptarë e aspak nuk veprojnë për shqiptarë dhe bashkimit shqiptarë, me shkrim e lexim të gjuhës shqiptare, liri e demokraci, tolerancë njerëzore dhe qytetnim; se para të gjithave para dymijë vjetve Dyrrësi kishte universitet; edhe me Kanunin e Lekë Dukagjinin që ishte juridika e kultura e jone per vetqeverisje, kishin rregull

të marrëdhanye njerëzore; me Gjergj Ariana e Voskopojën që kishte shtypshkronjën e shkrimit, para ardhjes së turqëve në Ballkan, kishte arsimim. Ta kuptojmë njiherë e përgjithmonë se me miliona shqiptarë me shekuj e sot nuk e kanë lëshue token me vullnet. Le ta kuptojmë se, as Roma, as Stambolli, as Vjena, as Athina, as Beograd e as Moska për tua plotësue dëshirën shqiptarëve, nuk ndërrojnë as arkivë as histori. Pra, edhe shqiptarët i kanë mendët e veta, histori e lashtësi të një gjuhe, të një gjaku dhe të gjyshave të përbashkët, te mos i harrojnë kurre. Po cili shqiptarë që i thotë vetit shqiptarë mund ta mohojë këtë? Me tragjedinë familjare e shqiptare, në krye me heroin tone Adem Jasharin, burra, gra e fëmijë, dhanë jetën për gjuhë e gjak, për tokë shqiptare, pra si qinda e mija të tjerë ja vdekje ja liri, mbi të gjitha si shqiptarë.

A na ka hije grindja e përçamja me njëni tjetrin? Apsolut jo! A kemi qenë ndonjiherë ma të ditun e arsimuemë me unversitete dhe ma të përfaqësuemë e pranuemë tek bota se sot? Apsolut jo! Kush duhet ta siell në çdo sferë të jetë mirëqenjen e shqiptarit sa vet shqiptarët dhe përfaqësuesit e tyne a vetëm shqiptarët, kurrkush tjetër? Apsolut po! A na ka hije tue i pasë të gjitha dispozitat e predispozitat nacionale e shtetnore e ti lejojme njanit e tjetrit t'na udhëheq, t'na pajtojë, ulë tensionet politike, xhelozitë, inatet, cmirën ... e na, tue i thanë vetit me aq lashtësi qytetnuese, të robënuemë gjithmonë e as sot nuk kanë mbarue temat e tokave shqiptare, po jemi të ndamë dhe diplomacia e sunduesëve tanë në shekuj vazhdojnë çdo ditë t'na përçajnë; a nuk duhet thanë me pakënaqësi?! Nëse sot i lejohet vetes, atherë asht faji i vet shqiptarëve. Po, pse kaq kundër njëni tjetrit?! A nuk u ngime me robënie e mjerime?! Nëse nuk i lejohet njeriut të aftë, të ditun, ai që bashkon njerëzit; udhëheqësit që motivizon ndjenjat dhe të vërtetën politike, histo-

ATEHËRE KUR FLITET PËR GJUHËN

“Një falenderim për librin : Në gjurmët e një didakti” me autor Prof.dr.Njazi Kazazi.

Ndër pesë elementët themelorë që krijojnë identitetin e një kombi dhe veçantitë e tij, është edhe Gjuha që përdorë ai komb. Jo më kot sot e kemi për nderë e krenari kur lexojmë atë çfarë kanë thënë e himnizuar për gjuhën tonë Budi, Bogdani, Naimi, Fishta, Mjeda, Petro Nini, Çabej e shumë e shumë të tjerë. Tek libri i Martin Camajt “Mergimi i gjuhës” takojmë dhe citojmë një thënie të shkrimtarit të madh francez GEORGE ARTUR GOLD-SMITH, i cili e vlersonte gjuhën në këtë mënyrë: “Gjuha amtare asht në fund të fundit kumbimi i formave që fëmija zbulon për herë të parë . Gjuha amtare asht frymëmarrja e veçantë e trupit njerzor, asht pragu përtej elementave dhe hapësirës”. Atëherë i bie , logjikisht, që njerzit që e ruajtën gjuhën tonë, madje edhe në kushtet e një sundimi të stërgjatë ku kerkohej edhe eliminimi i plotë i sajë, njerëzit që e studjuan atë, e pasuruan atë, i dhnë asaj gjithë fuqinë e dashurisë njerzore, ndergjegjsuan një nacionalitet të tërë për respektimin e sajë, sot meritojnë të nderohen po aq, sa ata që derdhen gjaskun për lirinë e pavarsinë e këtij vendi. Një ndër ta është edhe didakti i madh i Gjuhës Shqipe, i ndjeri Shefik Osmani, për të cilin Prof. Njaziu bën më të mirën e mundshme: Përrjetësimin e veprës së tij në librin “NË GJURMËT E NJË DIDAKTI”. Faleminderit edhe nga ana jonë o Prof. Njaziu! Edhe unë e pata fatin ta njihja Prof. Shefikun, ngaqë ishte pjesëmarrës në disa aktivitete të “Shoqatës Atdhetare-Dukagjini”, ngaqë kohë më parë kishte qënë nxënës i ish deputetit të parë dukagjinasi Prof.dr. Kolë Prelës, ngaqë me një zellë të paparë kishte botuar librin monografik : “Një misionar në shërbim të kombit”, kushtuar At Luigj Marlekajit”, por mbi të

gjitha e kam njohur nëpërmes kontributit të pasqor që ka dhënë në fushën e gjuhësisë dhe të edukimit. Gjithashtu , pata fatin që në një kohë, që ishte paskohë për mua, të kisha pedagog Pofesorin e nderuar Njazi Kazazi në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, dhe gjithë ato që mund të them për Profesorin nuk e kompensojnë ndjesinë e së mirës që ushqen vetëdija ime për Të! Megjithë njohjen e gjerë që ka, besoj se është e udhës që edhe lexuesi dukagjinasi ta dijë se kush është Prof.dr. Njazi Kazazi: U lind në Shkodër në vitin 1948, në një familje të mesme qytetare. Arsimin fillor, të mesëm e të lartë i mbaroi në vendlindje (1975). Punoi si mësues në Pukë (1966-71), në Shkodër (1975-84), si metodist i gjuhës shqipe (1984-91), drejtor i kabinetit pedagogjik (1991-93), didakt i gjuhës shqipe në Fakultetin e Shkencave Shoqërore dhe në atë të Edukimit në Universitetin e Shkodrës (1994 e në vazhdim). Kandidat i shkencave (1992). Profesor (2004). Ka kryer disa kualifikime në Universitetin e Bolonjës (1995, 2002), të Barit (2001), Sarajevës (2003). Ka botuar :-Udhëzues metodik për punën kërkimore-shkencore. (Tekst universitar). Shkodër, 2000, 148 faqe. Me bashkëautor : Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike. Tiranë 2000. 20-vjetori I Fakultetit të CU (1981-2001). Shkodër 2001. Universiteti i Shkodrës ndër vite (1957-2002). Shkodër

2002. Botime të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (1957-2002). Shkodër 2003. Organizim dhe drejtim arsimit. (tekst universitar). Shkodër 2003. Hyrje në metodikën e punës shkencore. (Tekst universitar). Tiranë, 2004. Bibliografi e artikujve të Buletinit shkencor të USH “Luigj Gurakuqi”, 1964-2004. Shkodër 2005. Në gjurmët e një didakti. Shkodër, 2005. Ka

gjurmët e një didakti” përfshin veprimtarinë dhe trashëgiminë e didaktit Shefik Osmani. E konceptuar si një monografi dhe e ndarë në tri pjesë, ky libër të rrëmben me brendinë rrugëtuese të Prof. Shefik Osmanit, dhe po kështu kompozimi që i ka bërë autori këtij libri është mjaftë mbresëlënëse , ku bie në sy linja e ruajtur kronologjike, eidentimi i kontributeve intelektuale të

familjes Osmani, shkollimi dhe dimensionit prej eruditi të jashtëzakonshëm të Prof. Shefikut, “vula” që ka lënë Ai në lëmin e gjuhësisë dhe pedagogjisë. Pjesët e futura në libër nga botimet e Tij, korospodencat dhe njohjet e tij me figura të lartësive evropiane, fotografitë e perdorura në libër, literatura e shfrytëzuar nga autori, i japin librit kaltërsinë e nevojshme, thellësinë e tejudkshmerinë e qellimit të paravendosur nga autori dhe çdo gjë tjetër që një lexues kualitativ e ka në menunë e tij të përditshme. Vlerat edukative, njohëse, pedagogjike e shkencore integrohen në shërbim të qellimit të librit , me aq mjeshtri nga autori, saqë shpeshherë homogjenizohen këndshem me njëra-tjetren dhe veçohen po aq lirshëm kur është puna për t’u përqendruar vetem në një drejtim. Ndëkohë që, gjithandej, kanë shpërthyer shkrime gazetareske të pafundme (nuk dua të ofendoj askënd), ku shpeshherë mediokriteti të mërzhitë deri në kulm, ndërkohë që poezia “po vdes”,

dhe aty-këtu, ku del ndonjë libër i tillë, të bie menjëherë në sy neotizmi i pafre dhe shkalafitja rreth temës vetmitare të një erotizmi afrodisiak, të botohet një libër i tillë, siç është ky i Prof. Njaziut : “Në gjurmët e një didakti”, është shpresë për rrethet intelektuale dhe do ta quaja si një varkë shpëtimi nga çudirat marroke, që na serviren gjoja si shkrime të vlefshme duke na u trumbetuar poshtë e lartë gjatë gjithë kohës. Askush nuk mund ta shprehë më mirë vlerën e këtij libri sesa dy fragmentet e shkruara në ‘shpinën’ e kopertinës së tij, të cilat duhen shkruar në këtë shkrim timin simbolik, por shumë dashamirës e me respekt edhe për të ndjerin Shefik Osmani edhe për autorin Njazi Kazazi. “Në gjurmët e një didakti” është një segment i historisë së arsimit tonë fillor gjatë gjysmësë dytë të shekullit XX, i shtjelluar nëpërmjet veprimtarive e kontributeve të didaktit Shefik Osmani, i cili vazhdon (tani nuk jeton më-shenim i imi L.K), rru-gen e brezave të mësuesve bashkudhëtarë të babait të tij. Duke u mbështetur në trashëgiminë e rilindësve, ai i përmbahet me besnikëri vokacionit familjar për edukimin bashkëkohor të brezit të ri me formim shkencor-human -atdhetar. Në këtë monografi dëshmohej për një opus të pasur veprash që shtjellojnë rrugë të vështira të arsimit tonë fillor kombëtar, shfrytëzime korridoresh të lejueshme për të ruajtur traditën, duke ecur paralel me hapat përpara që kërkonin kohët. Veprimtaritë që paraqiten dëshmojnë për përpjekjet e mënçura të mësuesve tanë të fillores, që duke mbajtur në zemër, mendje e në veprim edukatën kombëtare, kanë rendur nëpër korridoret e çelura nga rilindësit tanë dhe pedagogë didaktë të Pavarësisë”. Të falenderoj Prof. Njaziu për kohën që më more dhe “gropën” që mbushe brenda meje me këtë libër të vyer. Noli thoshte: “O burrani, përpara të derdhim dhe përhapim përmbi tërë viset e Shqipërisë, dete, oqeanë prej drite...!”

LAZER KODRA

Një lule për ty, MËSUES PRELA

-TË DUASH TË VËRTETËN DHE TË DREJTËN DO TË QUAJNË EDHE “NJË DUKAGJINAS KUNDER DUKAGJINASVE ...!”-

Të dashur lexues të gazetës “Dukagjini” ka kohë që e mbaj mbi shpatulla një barrë, e cila nuk më ka lejuar të jem e qetë! Kjo barrë është shprehja “një dukagjinasi kunder dukagjinave” e përdorur në një nga shkrimet e gazetës sonë, e cila është e hapur për të gjithë. Kjo fjalë, ju drejtua mësuesit dhe historianit të nderuar, Prel Grima,

i cili me argumente bindës, të bazuar në literature dhe jo në gojëdhëna dhe hamendje, (jashtë mundësisë së tij shëndetësore) na sqaroi mbi të vërtetat e luftës së vitit 1915, e cila u zhvillua në Plan kundër pushtuesit Malazeze, të cilat jo me saktësi janë paraqitur në librin “Përballja e Madhe e Planit”, me autor Mhill Palin. Nuk dua

të ndalem më gjatë në këtë aspekt, por gjejë rastin që të ju bëj thirrje të gjithëve, që kur të shkruajnë për historinë e vendit tone, pa dashur të fyej askënd, të ulen e të shfletojnë literature dhe të shkruajnë të bazuar në fakte të sakta dhe jo me hamendje. Historia nuk na lejon një gjë të tillë, sepse ajo do të shfletohet gjithmonë dhe brezat pastaj do

na qortojnë për gabimet tona.

Unë dhe shumë bashkëkohës të mijë jemi ndjerë të fyer për titullin e vendosur në këtë shkrim. Nuk mund të quhet “Një dukagjinasi kunder dukagjinave” një mësues si Prel Grima edhe pse në pozita mjaftë të vështira që koha ja solli, të na ushqej me dashuri për jetën, të vërtetën dhe Dukagjinin.

Unë kamë qënë nxënës në Shkollën 8-vjeçare në Grudën e Re, ku mësues Prela me shumë dashuri jepte lëndën e Historisë. Por kujdesi për mua dhe të gjithë nxënësit nuk mbaronte me rënien e ziles. Ne ishim pak nxënës nga Dukagjini në këtë shkollë gjatë viteve 70-90 dhe

si gjithmonë në këto vite ishim në shënjestër për të na u mohuar e drejta. Mësues Prela ishte për ne, Engjëlli mbrojtës.

Historinë dhe vlerat e Dukagjinit i mësuam nga Mësues Prela, i cili kur e shikonte se ndonjëri ishte i frikësuar të thoshte jam nga Dukagjini, Ai e merrte afër, i thoshte edhe unë jam Dukagjinasi dhe jam shumë krenar. E me një ëmbëlsi të radhë ai, na thoshte, pse ishte krenar se është Dukagjinasi. A mundet një njeri i tillë të quhet “Një dukagjinasi kunder dukagjinave”, të ishte kundër Dukagjinit? Jo! Kurrë,

vijon në faqen 7

PRELË GRIMAJ - NDERI I KOMUNËS SHALË

Me 6 mars, me rastin e ditës së mësuesit, Keshilli i Komunes Shalë nderoi me titullin "Qytetarë Nderi i Komunës Shalë", Prelë Grimaj. Ceremonia u organizua në Shtëpinë e Ushtarakëve. Merrnin pjesë dhjetëra banorë bashkëkoharë të Prelës, ish bashkëpunëtor dhe ish nxënës të tij në vite. Më të shumtët ishin nga vendlindja e tij, Lotaj por dhe fshatrat e tjerë të Shalës dhe Dukagjinit. Ishin edhe Kryetari i Komunës Shalë Balë Vuksani.

Këtë ceremoni, në emër të grupit nismëtar për të nderuar punën dhe veprimtarinë e Prelë Grimajt, e hapi Prelë Shytani, ish nxënësi i tij, sot dhe, prej vitësh drejtues shkollë. Ai foli për jetën dhe veprimtarinë e Prelë Grimaj, si mësues, si inspektor për arsimin që në Ministrinë e Arsimit, pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës dhe drejtor shkollë ndër vite. Ai foli edhe si ish nxënësi i tij duke sjell disa momente të veçanta të kohës.

Titullin e dorëzoi Kryetari i Këshillit të Komunës, Ndue Ndreaj me motivacion: "Për kontributin e dhënë në shtrirjen dhe zhvillimin e arsimit fillor e 7 vjeçar në zonën e Dukagjinit. Në veçanti për drejtimin e aksionit të madh për zhdukjen e analfabetizmit, i cili përfundoi në vitin 1956". Duartrokitjet e fuqishme të pranishmëve tregojnë vlerësim të Këshillit dhe të Komunës Shalë, por edhe Prelën, për vlerat e tij të krijuara dhe të ruajtura ndër vite, që e kanë bërë të dashur dhe të respektuar kudo që ka punuar dhe jetuar. Shumë emocionuese ishin fjalët, ndonëse të thjeshta, të pakta, por shumë të thella, shumë dashamirëse, shumë emocionuese për të gjithë të pranishmit në sallë. Ai e cilësoi këtë vlerësim më të rëndësishmin në jetën e tij, sepse, ishte vlerësimi që i bënte vendlindja e tij e paharruar.

Përsërisht me radhë, me fjalët më të ngrohta, me vlerësimet më të larta që mund ti bëhen në një rast si ky, ish nxënësi të Prelës, ish bashkëpunëtor dhe bashkëkoharë të tij, si Marash Malaj, Zef Lulashi, Ndue Sanaj, Ndue Prëndi, e te tjerë. Të gjithë me fjalë zemre, me respekt për punën e Prelës, për familjen Grimaj që në fëmijëri dhe gjithnjë, bënë përshkrimin e tyre dhe treguan jo vetëm respektin, por edhe shembullin e një familje me vlera të veçanta nga e cila mund dhe duhet marrë shembull secili. Përsërisht e bashkëkoharët të Prelës, Fran Shullani, ishte shumë e veçantë. Ai, me zemër të hapur, me atë zërin e tij të fuqishëm, me mendimin e tij të qartë, që ngjallën emocion dhe duartrokitje të fuqishme, i drejtohet Prelës dhe të pranishmëve: "Prelë Grimaj është nderi i Shalës dhe Dukagjinit që në moshën pesë vjeç dhe nuk i keni dhënë vetëm atë çfarë ka pasë të vetën".

Në mbyllje të kësaj veprimtarie me vlera jo vetëm për Prelën, por të gjithë banorët e Lotajve, Shalës, Dukagjinit dhe më gjerë, nën kujdesin e Armirit, që vërtetë është i mirë, u organizua një koktej mjaft i pasur, në të cilin të pranishmit takuan dhe uruan Prelën për nderimin që ju bë dhe për shëndet dhe mbarësi per-

sonale dhe familjare. Një vlerësim mjaft i mirë ju bë edhe nga mediat lokale të cilat e pasqyruan gjerësisht këtë veprimtarie.

Shumë shpejt, sapo u publikua kjo veprimtarie, me dhjetëra telefonata e mesazhe urimi i janë bërë nëpërmes telefonit apo në rrjetet e ndryshme sociale, nga ish nxënës, ish koleg dhe bashkëpunëtor në kohë të ndryshme, sa ishte vështirë edhe për tu përgjigje nga moshë gjendja shëndetësore – shpjegon vëllai i tij, Ndoci, dhe vazhdon "... e ka ndjerë me zemër dhe e ka vlerësuar shumë këtë nderim që ju bë në këtë rast, por ishte një vlerësim shumë i madh edhe për gjithë familjen tonë".

Prelë Grimaj, fillimisht ka punuar në Breglumi, pastaj ka shkuar në Universitet në Tiranë, nga aty në Ministrinë e Arsimit

guan shokët, ky e vazhdoi shkollën dhe përfundoi me rezultate të shkëlqyera.

Për rezultate të shkëlqyera, shteti i kohës i jep bursën për të studiuar në Bashkimin Sovjetik. Prela nuk e pranonte me qëllim për të ardhur në ndihmë sa më parë familjes dhe veçanërisht për të mundësuar arsimimin e vëllait të tij, Ndocit.

Prelë Grimaj donte që të arsimohej më shumë dhe pse 5 vjet pas mbarimit të shkollës së mesme, vazhdon shkollën e lartë në universitetin e Tiranës, tashmë i martuar.

Prelë Grimaj është simbol i qëndresës dhe papërkulshmërisë përballë mediokreve dhe paudhësive që ju kanë paraqitur në jetë. Sakrifika për të vërtetën, e cila ka qenë dhe është lajtmotivi i jetës së tij, nuk u kuptua dhe madje u shtrem-



si inspektor për Veriun e Shqipërisë. Për pamundësi strehimi kërkoi të vijë në Shkodër dhe emërohet në Institutin e Lartë të Shkodër, pastaj kalon në Komitetin e Partisë së Rrethit Shkodër, përsëri kthehet në Institutin e Lartë të Shkodrës, por, si i pa dëshirueshëm edhe në Parti edhe në Institut lagrohet edhe nga këtu dërgohet në shkollën 8 vjeçare Grudë e Re, dhe në fund të karrierës së tij punon në shkollën "Oso Kuka" në Shkodër.

Prelës dhe Ndocit u vdes baba e mbeten jetim në moshë të vogël. Në atë kohë Prela, që ishte i madhi, ishte 12 vjeç. Pra në moshën 12 vjeç, Prelë Grimaj mori stafetën e të zotit të shtëpisë, që duhet të përpiquej të ndihmonte nënën e tij, Lulë Sadikja dhe vëllain me të vogël në përbalimin e jetës me shumë vështirësi të kohës. Që në këtë moshë ju paraqitën një numër i madh sfidash që duhej përballuar.

Dëshira për tu arsimor qe shumë e madhe për Prelën dhe nuk e pati të lehtë të bindë nënën e tij që ta lejonte të shkonte në shkollën normale të Elbasanit, që e konsideronte si rrugën më të sigurt për të përballuar mjerimin, skamjen dhe prapambetjen e familjes, por edhe të shoqërisë në tërësi.

Arriti të shkonte në shkollë, por pothuaj të gjithë shokët më të cilët e filloj mësimin e braktisën shkollën. Megjithatë mbeti edhe një herë "jetim" pasi ju lar-

bërua ajo, prej së cilës i erdhën pasojat: përjashtimi nga Partia, ulja në detyrë, ulja në pagë, kalimi nga qyteti në fshat. Kjo ishte sfida e vështirë për Prelën! Nëse ato të parat ishin të vështira, por që të hapnin rrugën e së ardhmes, kjo ishte e trishtueshme, ishte sfida e zhgënjimit nga lufta për të vërtetën, nga dyfytërsia para saj, por edhe e shumë ish shokëve e disa kuadrove, madje, deri në institucionet dhe organet qendrore të partisë dhe shtetit.

Kjo përballje ishte e gjatë, me shumë strese, me provokime, me shantazhe, me shumë lodhje, por Prela qëndroi me vendosmëri duke vu në punë tërë potencialin fizik, moral dhe intelektual të tij. Kjo përbën madhështinë e qëndresës. Kjo qëndresë vulosi personalitetin e tij të lartë dhe të paepur. Prelës ju desh të përballonte presionet për bashkëpunimin me strukturat e kohës në emër të garancisë për të ardhmen.

Pasi largohet nga Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodër emërohet mësues në Grudë të Re ku punoi për 12 vjet. Aty nuk qe vetëm mësues, por qe vërtetë një edukator me vlerë shumë të lartë, korrekt në punë, marrëdhënie shumë të mira me nxënësit, kolegët, prindërit. Edhe sot gëzojnë respekt e mirënjohje nga të gjithë.

Jeta ka vështirësi nga më të ndryshmet, po vështirësitë edhe mund të largohen edhe mund të afrohen, në vartësi të kushteve që krijohen. Për kushtet që ju

krijuan artificialisht Prelë Grimajt, mund të kishte pasojë edhe më të rënda shëndetësore dhe fizike, por me qëndrueshmëri dhe vullnet të hekurt u ka bërë ballë në mënyrën më të mirë të mundshme. Gjithsesi nuk mund të mos sillnin pasojë që ndikuan edhe në shëndetin e tij. Që prej 18 vjetësh përballon guximshëm dhe me vullnet, që mund të jenë model për çdo njeri, një paralizë të pjesshme në gjymtyrë. Kjo sëmundje e ka lodhur vetëm fizikisht në gjymtyrë, por nuk ka asnjë ndikim në të folurit dhe të menduarit e tij, të thellë, të qëndrueshëm dhe me shumë energji.

Mos vlerësimi është një moment shumë i rëndë në veçanti për atë që ka punuar dhe ka dhënë një ndihmesë me vlera për shoqërinë. Kështu ndodhi edhe me Prelën. Në vitet para '90 i drejtojnë gishtin dhe e përjashtojnë nga Partia, e largojnë për arsye politike, biografike. Pas viteve '90, kur mund të merrte merita si shumë e shumë të tjerë, përsëri i drejtojnë gishtin me moton, ke qenë komunist.

Prela, në pleqëri dhe në gjendje jo të mirë shëndetësore bashkë me të shoqen, Shkurta duhet të përballonjë, si shumë të tjerë, largësinë e fëmijëve. Ata kanë tre djem mjaft të mirë që kanë marrë rrugët e botës bashkë me familjet e tyre, për një jetë më të mirë. Ata mirë janë, por për Prelën, veçanërisht, kanë krijuar një boshllëk të madh edhe për vetë gjendjen e tij shëndetësore. Por është karakteristikë se, Prela nuk ankohet, e përballon me vullnet të fortë mungesën e tyre. Ai ka 13 pjesëtar të familjes në emigracion që i mungojnë shumë.

Prelë Grimaj është një ikonë e përhapjes së arsimit, kulturës dhe shkencës në Dukagjin, por edhe më gjerë. Ai është hulumtues dhe studiues i vëmendshëm i historisë dhe kulturës së krahinës dhe më tej. Është i drejtë, i hapur dhe drejtpërdrejtë në dhënien e mendimeve, nuk flet pa u menduar mirë, por atëherë është i vendosur në mendimet e tij. Ai është intelektual me vizion të gjerë shoqëror. Hulumtues dhe mbrojtës i vlerave përparimtare krahinore dhe nacionale. Prelë Grimaj është nga ata dukagjinasi që gjithmonë ka mbrojtur nderin dhe dinjitetin e Dukagjinit dhe dukagjinasi, të vërtetën dhe fjalën e lirë, ka mbrojtur dhe mbron vlerat, historinë, traditën dhe kulturën tonë të mirë. Ai është një model për tu marrë shembull për nivelin kulturor, arsimor, tolerancën, vendosmërinë, papajtueshmërinë me negativën dhe me prapambetjen.

Është edukator i shkëlqyer i familjes dhe të gjithë atyre që kanë mundësinë dhe dëshirën që të kërkojnë mendimin e tij.

Edhe personalisht e uroj përzemërsisht intelektualin, dashamirin, mësuesin dhe mikun tim Prelë Grimaj, me rastin e shpalljes "Qytetar Nderi i Komunës Shalë", por uroj edhe Komunën Shalë dhe Këshillin e saj për këtë vlerësim shumë të vlefshëm.

Nga **Luigj SHYTI**

Bashkëbisedimin me Ndrek Gurin

Kush është Ndrek Guri?

-Ndrek Guri është djalë i një familje fisnike dukagjinase. Kam lindur në Brashtë të Shoshit në vitin 1935. Në vitin 1945 kam vazhduar shkollën fillore në Salcë të Merturit, ku pas përfundimit të shkollës duke u nisur nga rezultatet e mira në mësimet u caktova që të vazhdoja një kurs pedagogjik për mësues fshati, ku këtë profesion nuk u lejova të ushtroja kurrë për shkak të biografisë së keqe politike. Në vitet '70 kam banuar në qytetin e Shkodrës. Aty mu krijua mundësia të vazhdoja shkollën e rezervave të punës në degën elektrike, pastaj kam punuar në veprat e mëdha të dritës. Në vitin 1994 kam shkuar në SHBA dhe aty familjarisht jetojmë e punojmë.

Duke qene djalë i Dukagjinit, fshatit Brashte të komunës apo të krahinës së Shoshit, çfarë është për ju Brashta, Shoshi dhe në tërësi Dukagjini?

-Vendi më i ëmbël në botë, ku malet puthen buzë për buzë me qiellin, ku dielli më parë se kudo tjetër u thotë maleve, -Mirëmëngjesi -dhe së fundmi-Natën e mirë.


"Çudi në andërr mramë kam pa / Në atdhe larg ku kem jetue / T' parin gjum porsa kam ra / Brashtën time tue kujtue!"

Në këtë mes, sa e ndjeni veten dukagjinase?

Duke u nisur nga virtytet e mrekulueshme të dukagjinaseve dhe jetën e lavdishme të të parëve tanë unë e ndiej vetën tërësisht dukagjinase, por i ngarkuar me një barrë mjaft të rëndë, e cila na fton çdo ditë të lutemi, të punojmë dhe ta dëshmojmë vetën si pasardhës të këtyre legjendarëve. Ku këto vlera, këtë histori duhet jo vetëm ta trashëgojmë por edhe ti japim jetë kudo që jetojmë e punojmë.

Sa kohe keni në SH B A, në Miçigan dhe cila është veprimtaria e juaj?

Ashtu siç e thashë edhe më lartë jam që nga viti 1994 ku jetoj e punojmë familjarisht. Për këtë unë e falënderoj sa të kem frymë bashkëfshatarin tim, Dom Prek Ndreveshën, i cili mu bë një babë



i dytë duke më afruar, ndihmuar dhe këshilluar. Së bashku me disa vëllezër dukagjinase, ne veçanti Ndue Ftoni dhe Pëllumb Kulla, jam nismëtari i krijimit të Shoqatës "Dukagjin" në Miçigan. Kemi dhe po punojmë gjithë përkushtim për promovimin e vlerave dukagjinase në komunitetin shqiptar në Amerikë.

Me datën 8 shtator 2012, në Kishën e "Motrave Sigmatine", nen kujdesin e Famullisë së "Shën Shtjefnit" dhe personalisht te Famullitarit të kësaj famullie, Dom Gjovalin Sukës, betë prezantimin e librit të dyte ne qytetin e Shkodrës, madje një libër të veçantë, që ja kushtoni një kleriku të madh, dom Preke Ndreveshes. Çfarë ju shtyu që të ndaleshit te kjo figure e madhe, siç ishte dhe është dom Preke Ndrevesha?

Kam dëshirë të sjell për ju disa vargje që më kanë dal nga shpirti kushtuar të mallit Dom Prek Ndreveshës: *"Si zog pa fole gjithnji në shtegtim / Me dashtni hyjnore ti për njerëzinë / Krishtin në zemër në jetë pa mbarim / Shtegtarve u*

bane dritë të gjejnë lumturinë!"

Këto vargje më duket se e shprehim mjaft mirë se kush ishte Dom Preka, jo vetëm për Ndrek Gurin, por për të gjithë Shqiptarët që nga regjimi komunist u larguan nga atdheu i tyre. Ne për Dom Prekën ishim zogjtë e folës së tij dhe ai kujdesej për ne, për të na sjellë të gatshëm ushqimin shpirtëror dhe ma tej. Pos Zotit në qiell, Dom Preka për ne ishte shpresa e dytë, e cila gjithmonë na u përgjigj me dashni të madhe.

E pikërisht kjo më ka shtyrë që në shenjë dashnie dhe respekti për dom Prekën, të shkruaj këtë monografi.

Në hulumtimin, studimin dhe per gatitjen e kesaj monografie patet veshtiresi, në cilin drejtim ishin ato?

Ky libër ka dashtë përkushtimin e tij. Por kudo trokita për të marrë materialet e paraqitura në libër. Unë kam gjete gatishmërinë më të madhe, dhe kjo vjen fal dashnisë që persona në fjalë kanë për Dom Prekën ... Për këtë unë i falënderoj të gjithë me zemër, sepse më ndihmuar shumë.

Në këtë prezantim të këtij libri në Shkodër, vini pas prezantimit të tij në Miçigan. E veçanta midis këtyre dy prezantimeve?

E veçanta ishte vetëm kjo, në Miçigan në sytë e pjesëmarrësve shikoja lotin e falënderimit për Dom Prekën. Ndërsa në Shkodër shikoja lotin e mallit gjysmë shekullor dhe krenarinë që ishte i yni.

Në fushën e krijimtarisë, a mund të na thoni planin tuaj?

Në krijimtari gjithmonë unë i kam planet e mëdha, sepse Zoti më ka dhuruar shumë dhe unë duhet ti përgjigjem Atij vazhdimisht. Deri tani, duke ja filluar me "Brejtësit e shpresës" e në vijim, unë dhe lexuesi jemi ndier mirë me njëri-tjetrin dhe shpresoj që kjo do të vazhdojë edhe në të ardhme. Gjej rastin të ju falënderoj se, ju si Shoqatë në vazhdimësinë e punës suaj të mrekullueshme më keni dhënë zemër dhe ndihmën e duhur.

I nderuar Ndrek, dalim pak nga krijimtaria e juaj. Ju jeni, se bashku me shoket e tjerë dukagjinase, krijuesi i shoqatës "Dukagjini" në Miçigan dhe deri para disa muajsh keni qene kryetari i saj. A mundet ti thoni lexuesit te gazetës "Dukagjini" mbi misionin dhe perspektiven e saj?

Po! Misioni i shoqatës sonë është i qartë. Promovimi i vlerave dhe sensibilizimi i tyre. Jo të gjithë na njohin se kush jemi dhe sa të mirë jemi. E për këtë ne duhet të jemi të bashkuar e të punojmë ditë e natë sa të kemi frymë. Perspektiva është e mirë, hapat e parë janë hedhur. Shpresojmë që duke ecur në këtë drejtim me dashuri dhe përkushtim ne, do të rritemi edhe më shumë për të mirën e Dukagjinit..

Dukagjini është pjesë e Shkodrës. Sa e ndjeni veten shkodrane dhe çfarë mund të na thoni për Shkoderlocen?

A, përsëri do ti sjell lexuesit disa vargje: *"Shkodra e Rozafës e Marin Barletit / Qysh në ata shekuj dallue për urti / Murlani i veriut as dallgë e detit / S'ta ftohën gjakun me të lanë në robni ..."*

Jam shkodran, sepse jam dukagjinase dhe jam dukagjinase, sepse jam shkodran. Për mua Shkodra është ZEMRA dhe Dukagjini është GJAKU ...

Të është dhënë mundësia të njiheni me gazetën "Dukagjini" dhe në qofte se po, çfarë mund të na sugjeroni në forme dhe në përmbajtje?

Gazetën Dukagjin unë çdo muaji e lexoj kur jam në SHBA në faqen e Ëeb të Shoqatës dhe kur jam në Shkodër marr gazetën. Ju lumtë! Kjo gazetë, tani e them me plot bindje, është një dritare e hapur jo vetëm për dukagjinin, por edhe për Shkodrën. Sugjerimi është të vazhdojmë të të japim jetë sa më të gjatë. Gjej rastin të ju bëjë thirrje të gjithëve që ta mbështesim me krijimtari dhe financim. I falënderoj të gjithë ata që kanë punuar dhe po punojnë për këtë gazetë, por në veçanti mundësorët e saj, Gjegj Leqejza dhe Ndue Ftoni dhe ne veçanti redaksinë e saj.

Në përfundim, i nderuar Ndrek, ju falënderojmë për intervistë dhe si do e mbyllim këtë intervistë?

Sa herë ty flamur vera tu ba dimën / Bashkoi të dy krenat e trupin kuq e zi / Largo dhunë e terror përjet kthejua shpinën / Shndrit si rreze dielli gjithmon mbi Shqiptari...!

Më lejoni të uroj, me urimin popullor, Ndrek, kujdes me faqe të bardhe!

Faleminderit!

**Bashkëbisedoj
Ndue Sanaj e Roza Pjetri**

Një lule për ty, MËSUES PRELA

vijon nga faqja 5



sepse ne, na rriti me Dashuri për Dukagjinin. Këtë, nuk ta lejojmë kurrë! Një njeri, i cili është ndjerë i fyer sepse dikush e ka korrigjuar për pasaktësi, ose jo në lidhje me atë çfarë ka shkruar për historinë e një ngjarje apo vendi, mund të reagoj, por jo në atë mënyrë, e cila

tregon mungese formimi të reaguesit ... Të gjithë jemi ndier të fyer kur Mësues Prela është quajtur kështu, prandaj tani do të jap disa mendime të bashkëmohatare të mijë për vlerat e Mësues Prelës:

Vjollca Boshi-Mësuese në Udineze

Sa here e dëgjoj të përmendet emri i mësues Preles, e ndiej dorën e ëmbël të tij, tek na takonte. Në takimin e parë të tij, ishte buzëqeshja, e cila të afronte dhe të largonte çdo ndrojtje. Sa bukur më tingëllon fjala e tij kur më thërriste, ku je Vjollca e Thethit, ti je lulja më e bukur. Ai ka qenë shumë i dashur dhe mua më ka mbështetur shumë që të vazhdoja shkollën e mesme dhe pastaj të lartën, sepse vija nga një familje me probleme politike te asaj kohe. Isha e dëshpëruar për atë që më priste, ai më jepte kuraja për të vazhduar. Ai ishte plot shpresë për mua!

Nikolin Shqau-Biznesmen

Mësues Prela! Mësuesi që është skali- tur thelle në shpirtin tim. Ai na ka ushqyer me dashuri për vendlindjen time. Mua më thoshte tani po vjen Vera dhe ti duhet ti kërkosh babës Martin të të çoj në Shllak. Niko mos lejo ta shikosh Cukalin nga larg por shko dhe preke atë me dorë.

Kjo ishte shtyja ime e parë që unë ta prekja me dorë bukurinë e vendlindjes time. Nga

ai, mësova për figurat e ndritura që Shllaku i ka dhuruar historisë, artit dhe sportit. Ishte i pari, i cili edhe pse rrezikonte shumë, që më ka folur për Martin Camën. Atëherë nuk e kam kuptuar këtë rrezik, por tani unë e di sa shumë ka rrezikuar mësues Prela për të na ushqyer ne, me dashurinë për Dukagjinin.

Katrina Kodraçi (Javani) -Mjeke

Të flas për Mësues Prelën duhen ditë të tëra. Ai për mua ka qenë një mbështetje e madhe që unë të vazhdoja shkollën. Dua të korrigjoj vetën, jo për mua por për të gjithë nxënësit e mirë të shkollës me prejardhje nga Dukagjini. Në mbledhjen e Këshillit pedagogjik ai, për ne ishte shumë këmbëngulës që të na mbron. Nuk lejonte që për arsye që tashmë bashkëmohatarët tanë i njohin, të na "hahej haku". Ai me mirësjellje e ngrinte zërin që ne të na jepej ajo që ne meritonim, nota dhe e drejta e bursës apo e shkollës. E kujtoj se, sa me dhimbje i përjetonte disa raste ku nxëniet shembullor me prejardhje nga Dukagjini, për arsye politike te asaj kohe, ju mohojë e drejta e studimit apo edhe dalja e emrit në tabelën e të dalluarve. Shumë nga intelektualët dukagjinase, sportistë-ish nxënës

të Mësues Prelës, theksojnë: Ai, na dhuroj ndihmën, nxitjen për të ecur përpara dhe për të mos u dorëzuar. Në ecjen tonë Mësues Prelën e kemi pasur gjithmonë mbështetje. Ai ka ardhur na ka takuar në Institut dhe në Shkollën e Pallatit të Sportit dhe të Stadiumit. Ai krenohet me ne dhe ne me Mësues Prelën.

Të dashur lexues janë të shumët ish nxënësit e tij, të cilët në këtë Mars, në muajin e festës së Mësuesit, dhe ne veçanti me nderimin e madhe që i beri Këshilli i Komunës Shale, duke i dhënë titullin e lartë **"Qytetar Nderi i Komunës Shale"**, i urojnë jetë të gjatë dhe shëndet të plotë Mësuesit të tyre, Mësuesi tone të dashur. Ai për ne gjithmonë rrezatoj dashuri dhe përkujdesje. E si mundet te lejojmë që ai të quhet **"Një dukagjinase kunder dukagjinaseve?"** Jo e jo!

Koha njeriun e mirë dhe të ndershëm që punon dhe jeton, për të Mirën, për të Bukurën dhe të Vërtetën e vret e shkelmon!? Kjo nuk qëndron, sepse ai që e ndërton Jetën mbetet gjithmonë i pavdekshëm!

Mësues Prela FLEMIDNDERIT !

Nga Roza Pjetri

DUKAGJINIT I DUHET NJË BESLIDHJE E RE POLITIKE DHE NJË BEBE GRILO

- FTESE PËR DEBAT INTELEKTUAL -

Në se Shqipërisë i duhet një Bebe Gligo, Dukagjinit i duhet super Bebe, edhe 100% më i "çmendur" se komiku italian, pasi Shqipëria dhe aq me tepër Dukagjini janë disa shekuj larg kulturës politike të Italisë fqinje. Jemi në prag të formimit të përfundimtarë të listës së kandidatëve për deputet të dy grupimeve të mëdha politike, por askund në horizont nuk duket as shenjë, apo shteg sa do i vogël që në listat e Qarkut të Shkodrës të ketë as një dukagjinasi as djathtas as majtas. Politika imorale (e madhe) e Tiranës ka plor 16 vjet që Dukagjini e ka përjashtuar nga përfaqësimi në konakun ku gatohen ligjet e këtij vendi. Edi Rama u tha dje aleteve të vegjël doni ministri apo deputet shkoni e mblidhni 5000-10 000 vota, aritmetike e sakte dhe konkrete. **Më vjen të ulëras e te çirrem si i çmendur! Ku jeni ju shkollarë të Dukagjinit mbi (500 me shkolla të larta) që rrini si qypa duke pritur çfarë do ju falin të tjerët?! Akoma nuk e keni kuptuar se politika shqiptare nuk ka nënë, as babë, as motër e as vëlla, madje as besë as moral.**

Një ish eksponent i lartë i PD në Shkodër i afirmuar që në lëvizjet e para demokratike të këtij qyteti më tha: -Si nuk ju vjen marre kur keni gjithë ata njerëz me diploma të mos përfaqësoheni politikisht? Më vjen shumë keq që ju kanë përdorur pa ndershmërisht dhe po thuaj nuk keni përfituar as gjë, ndonëse bujarisht dhe besnikërisht 20 vjet votoni masivisht PD. Më vjen të çirrem e

te mallkoj me te madhe, dreqi ua marrtë diplomat o rrogëtaruc të vegjël, që akoma nuk e keni kuptuar se kur të mohohet e drejta politike nuk ke defakto as një të drejtë tjetër. Turp për mua dhe gjithë kolegët e mijë që kemi rënë aq poshtë sa pranojmë gojëkëqur statusin plebeut për me se 20 vjet. Le të më quani si të doni



por u bëfsha m... në taserat e partive pa dallim ngjyre, kur ato u mjelin si lopën duke u marrë çdo korrje elektorale mbi 20 mijë vota. E çfarë ka përfituar Dukagjini nga torta e pushtetit përveç se, një grushti mitingash kokëkrisur dhe komisionarësh besnik që kanë degjeneruar pothuaj çdo proces votimi në Dukagjin,

të cilët janë shpërblyer me nga ndonjë kockë dhe trajtuar si sahan-lëpirës pa pikë dinjiteti. Unë nuk jam aq primitiv sa të ëndërroi për principata politike apo aq me tepër regjionale. Unë kërkoj të drejtën politike të një krahine që vetëm në Qarkun e Shkodrës ka mbi 15 mijë votues dhe që në mënyrë djallëzore i mohohet

përfaqësimi. **Dukagjini ndihet i përfaqësuar politikisht kur në listën shumë emërore kandidatëve të PD-së të Qarkut (Prefekturës) së Shkodrës, emri i një dukagjinasi të jetë gjithmonë, i 4-ti ose jo më poshtë se i 5-ti, ndërsa tek lista PS-së jo më poshtë se nr 5-së.**

Në Perandorinë Osmane krahina

apo Vilajeti i Shkodrës kishte ketë hierarki politike TOPHANA (Shkodra si qytet)-HOTI (Malësia e Madhe)-MIRDITA (Orosi)-DUKAGJINI (Shala)-PUKA (Kabashi) dhe LEZHA. Sot për sot politikisht, në shtetin demokratik shqiptar jemi më të diskriminuar politikisht se në Perandorinë Osmane, më të diskriminuar se në Perandorinë e Savojës e Regjencës gjatë Luftës së dyte dhe shumë më të diskriminuar se në kohën e diktaturës së Enver Hoxhës. Vini re me vëmendje: -Përveç se Dukagjinit, cila nga këto krahina nuk përfaqësohet politikisht në Kuvendin e Shqipërisë. Ne, sot në Shkodër quhemi shtresë e ultë politike (**dhe ashtu vërtetë jemi**) përderisa nuk e kemi as një roje të punësuar në Bashkinë e këtij qyteti. Edhe në dasmë, festë apo mort, kur nuk të jepet vendi që të takon aty nuk ke bukë. Po, pranove bukë të tillë është bukë pa dinjitet. **Dukagjinasi ka plot 16 vjet që politikisht po e hanë bukën me marre!** Kur ke një masë të tillë elektorale nga pas dhe padronet e politikës Rama dhe Berisha në mënyrë poshtëruese të përzënë nga defteri i tyre atëherë çfarë duhet bërë?! Përpara një fakti të tillë të kthyer në vijë dashakeqë shumëvjeçare politike, duhet një grusht i fuqishëm që t'i sjelli në vete (PS-PD) dhe të mësojnë një herë e mirë se, Dukagjini ka një karigë me status të përhershëm në Kuvendin e Shqipërisë. Që kjo e drejte e mohuar të arrihet na duhet t'i thërrasim mendjes së hallakatur, të ngrihem me vetëdije mbi naivitetin dhe mungesën e unitetit komunitarë që na karakterizon, duhet të bërë një "Beslidhje të Politike" (e gjerë si dikur motit). Na duhet edhe një Bebe Grilo, për të treguar vitalitetin (testin) tonë politik te mohuar në mënyrë tinëzare dhe pasi ta fitojmë këtë të drejtë, le të shpërndahemi e të shkojmë me dinjitet, secili në familjen e vet politike.

Nga Prelë Milani

LETËR e LIN DELISE

Nënprefekti i Nënprefekturës së Dukagjinit

Relacion: Mbi fillimin e Kryengritjes së Dukagjinit, Shkodër, me 3.12.1926

PROFEKTURËS SHKODËR

Ju njoftojmë se me datë 19. 11. 1926 ora 6 afërsisht paradreke, na paraqitet një i quajtur ... nga Shala, Lagje Lotaj, i cili na njofton se mbasi informatave të marruna, **Dom Loro Cak ish famullitar i Mazrrekut së bashku me ish oficeret Ndokë Gjeloshi, Vas Kiri, Spiro Kosova dhe Dedë Kolë Thani, me 30 veta nga Jugosllavia dhe 30 të tjerë kriminel të arratisur shqiptarë kanë hy në Dukagjin dhe ndër këto ditë donë me ba një ofensivë kundra Nënprefekturës lokale.** Sipas lajmit të marrë pa u vonue as një minut u ba një telegram për me ju lajmëruar dhe ju dha Sekretarit për me shkue në Komandën e Rrethit, ku prej aty do të bante telegramin në fjalë. Por i përmenduni sekretar u kthye pa mujtë me dhanë telegramin e tuj lajmëruar se teli nuk punonte, ku ma vonë u muar vesh se teli ishte kenë pre prej kryengritësve. Për te dhanë lajmin e ngjarjes mbasi teli ishte këputë, u thirr një i quajtur ... nga Shoshi, i cili banonte afër Nën-

prefekturës dhe i njoftun si besnik i qeverisë, për me dergue tekstin e telegramit Prefekturës së Shkodrës. **Nder këto i sipërpërmenduri Bajraktari i Shoshit së bashku me Ndokë Mirshin nga i njajti katund, të cilët më lajmëruan se komita kishte ra në Shalë dhe lypë dorëzimin e zyrave të Nënprefekturës, po në ketë minut mbërriti edhe Bajraktari i Shalës Lush Prela së bashku me kushëririn e tij Pepë Ndreu, të cilët me lajmëruan edhe këta se ka ra komita me zaptue zyrat. Me sa ishim në bisedime me Bajraktarët e sipërpërmen-**



Qendra e Rrethit Dukagjini . Koder Shen Gjergji

dur arriti edhe Nëntoger Mark Sadiku ku edhe i cili kishte kenë i influencuem si dy bajraktarët në fjalë. Tuj pa ketë gjendje me urgjence u lajmërua Komanda e rrethit për me marrë masa të shpejta ... Po megjithëse ky urdhër u dha, Rreth Komanda për këto veprime urdhini mbet i vdekun pasi xhandarët e Rrethit që ishin vendas ishin largue prej qendre dhe bashkue me kryengritësit ... **Nga bisedimet e bame me bajraktarët u muar vesh dhe u vërtetue se aty nuk ashtë çështje një komite prej 60 a 70 vetash, por ishte një Kryengritje e Përgjithshme prej 9 bajrakëve të Dukagjinit,** ku u pohue edhe nga dy bajraktarët. Në orën 4 pas mesnate prej Rreth Komandës erdh Nëntoger Mark Sadiku së bashku me Zëvendësin e Rrethit, Z. Maliq Dibra, ku Nëntoger Mark Sadiku mori fjalën dhe tha nuk ashtë e mundun ta mbajmë rrethin se fuqia ashtë e paktë, d.m.th prej 10 vetash ... Titullari i Kësaj Nënprefekturë tuj pa se të gjitha shtigjet ishin mbyllë ashtu dhe fuqia e armatosur fare e paktë dhe e demoralizue, si mbas provave që dhanë se nuk kanë kurrfarë mjet qëndrese në përfitim të regjimit Republikan. Ky ishte reagimi që t'u kërkojë bajraktarëve të Dukagjinit, ose ma mirë me thanë kryengritësve të mbarë Dukagjinit lirimin e udhës për të gjithë xhandarët qi mbetën besnik të qeverisë, ashtu edhe për personelin e Nënprefekturës lokale

me kalue me nderim të armëve, ose për ndryshe ishin gati me deke e mos me dalë pa nderin e armëve. Mbasi kryengritësit u morën vesh me shoqi-shoqin, prej të dy Bajraktarëve kjem të lajmëruem se udha që xhandarët dhe oficerët së bashku me personelin e Nënprefekturës dhe besnikët e sajë të jenë të lirë me kalue me armë. Në ketë rast mbasi Bajraktarët nuk u gjegjen me ardhë me personelin e Nënprefekturës, zyrat mbet në dorëzim të tyre dhe kështu u nisa deri në Mal të Shoshit dhe u përcollëm prej Nëntoger Mark Sadikut, i cili nuk gjegji me ardhë ma andej, por u kthye tuj thanë se do të shkoj te shtëpia. Neve morëm drejtimin për në Prekal dhe me që ramë te Post Komanda telefonisht lajmëruam Prefekturën dhe Komandën e Zonës mbi ngjarjen e ndodhur në Dukagjin. Por sa ishim tuj mbledhë banorët e Prekalit që me mujtë me ba qëndresë, kjem të lajmëruam se kryengritësit kishin ra tek Ura e Prekalit dhe na kjem të shtërguem me u ulë deri në Driht, ku aty përsëri lajmëruam Komandën e Zonës, për të marrë masat të shpejta që të mos u jepte shkak hapjes së ngjarjes.

Sa për propaganda te bame në Dukagjin prej të arratisunve Ndokë Gjeloshi me shokë ashtë kenë e lajmëruam Ministria Punëve të Brendshme me telin Nr 42/res, e përsëritur deri me 46 herë, të cilat fakte flasin mbi ç' ka u tha sipri.

KOSOVA LINDORE NË VORBULLËN E KRIZËS BALLKANIKE



Reshat AVDIU*

Prania dhe vazhdushmëria e pushtetit represiv serb në Luginë të Preshevës, ka arritur në një moment tepër të tensionuar me tendencë të acarimit të mëteshëm të situatës politike dhe të krizës së theksuar ekonomike në këtë rajon tejte të varfër shqiptar dhe më gjërë. Edhe fuqitë e mëdha botërore që sot gjithkund nëpër rajone ndezin vatra të tensionuara, pastaj kur flaka e këtyre luftërave merr përmasa të mëdha, po të njëjtat fuqi botërore tentojnë që zjarrin t'a shuajnë me një të sjellur nga një tantan i madh dhe gjithçka t'a shndërrojnë në fluskë sapuni. Kur ne shqiptarët e Luginës së Preshevës u vetëdijësuaam për të drejtat tona legjitime, edhe neve këto filluska sapuni na u servuan dinakërisht, me marrveshjen e Konçulit. Ku do t'a ndalnin për një moment të caktuar luftën e drejtë dhe të pakompromis të UÇPMB, për t'i dhënë shansë kinse zgjidhjes paqësore në këtë pjesë të Shqipërisë së Vjetër Verilindore, e cila një shekull e më tepër është nën kolonializmin dhe hegjemonizmin serbo-sllav të Karpateve të Rosisë.

Qysh në fillim të bisedimeve në Konçul, thelbi i tezës ishte më se i qartë, tentohej të krijohet përshtypja e rreme, se shqiptarët nga Lugina e Preshevës, mund të fitojnë diçka pas kësaj marrëveshjeje. Serbia, nga ai moment përsëri filloi t'a mbrehë thikën në farkë që nga mëngjezi gjerë në darkë. Për t'na eliminuar tash, kësaj rradhe përfundimisht si qenie biologjike, neve shqiptarëve nga trojet tona etnike të Shqipërisë së Vjetër Verilindore si në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Popull i Luginës së Preshevës!

Armiqët, dhe disa servilë tanë partiak, po tentojnë sot t'i godasin dy lepuj me të njëjtin guri: Krijohet një etnitet serb në Kosovë, ndërsa nga ana tjetër Lugina e Preshevës, mbetet e kolonizuar, gjë e garantuar përmes pranisë së ushtrisë dhe xhandarmerisë serbe këtu tek ne. Pastaj krijohet, krejtësisht përshtypja tjetër e rreme në popull - e barazimit, të një pjese të Kosovës, tokë shqiptare, me Luginën e Preshevës, kinse tjetër tokë shqiptare, për t'i realizuar premisat e asaj që në fakt Beogradi e dëshiron sipas logjikës së tij aneksoniste - shoveniste. Ky është një pazar i fëlliqur për shkëputjen e një

pjesë bukur të madhe të Kosovës në këmbim me Luginën e Preshevës. E kjo është e papranueshme, për popullin tonë të Kosovës Lindore dhe bijtë e saj liridashës të ish'UÇPMB'së, dhe veprimtarëve tjerë të çështjes sonë të madhe, e së bërit Shqipërinë - Shqipëri. Dhe se këtë nuk do të lejomë dhe s'pajtohem kurra-kurrës, që as edhe një pëllëmbë tokë shqiptare të këmbehet as të mbetet nën pushtimin e kolonializmit serb dhe sllavomaqedonas.

Zotrinjë kolaboracunist të Beogradit!

Popullatën autoktone të kësaj ane të Shqipërisë së Vjetër Verilindore, e keni sjellë me thikë në fytyrë, tash së fundi me formimin e ashtuquajtur "Këshill Nacinal të Shqiptarëve" neve nuk na ka mbetur gjë tjetër, vetëm t'a përsërisim dhe t'a raelizojmë në praktikë atë apotheozën e Rilindasëve tanë mbi robërimin dhe glabërimin e tokave të Mëmëdheut tonë e cila thoshte: **"Jo për besë nuk duam azgjë nuk, vetëm se armë edhe ca bukë."**

Shqiptarët duhet sot me të drejtë t'a ngrisin problematikën në instanca më të larta ndërkombëtare, rreth çështjes së pronave tona të patjetërsueshme në Shqipërinë e Vjetër Verilindore të Nishit, Toplicës dhe Qarkut të Vrajes. Se ato troje tona stërgjyshore gjer më sot nga askush as nuk u blenë dhe as nuk u shitën por vetëm se u suprimuan me dhunë dhe terror, gjatë viteve 1877-1878, nga pushteti atëbotë i Millan Obrenoviqit, i cili e parapëlqente shtetin e tij një nacional serb, dhe do të propozonte atëbotë: *"Sa më pak që të ketë shqiptar në mesin tonë, aq më e madhe do të jetë merita për atdhe dhe sa më shumë shqiptarë që të shpërngulni, aq më i madh do të jetë suksesi për Serbi"*. E njëjta praktikë do të vazhdonte edhe gjatë viteve 1912-1941, atëbotë një kryeçetnik shkruante: *"Do të isha shumë i lumtur, kur Kosta Peçanci do të na japë urdhër neve serbo-çetnikëve të tij, dhe se lumejtë e Kosëvës si: Llapi, Sitanica, Ibri dhe Drini do të bartin dy muaj koka të shqiptarëve, dhe se në Kosovë nuk do të mbetet, asnjë plisë për fare. Pastaj do t'i ndërtojme kampet e pëqëndrimit, për shqiptarët se ata të gjithë janë kriminel..."* - shkruhej më 1945, për shfarosjen dhe eliminimin e qenies biologjike të shqiptarëve.

Ndërsa në planin e Millosheviqit dhe klikës së tij morbide gjatë viteve 1989-1999, për shfarosjen e popullatës shqiptare thuhej:

a) Në Kosovë toka e djegur duhet, t'i përfshijë të gjitha anët e saj.

b) Tymi i vatrave shqiptare të dëshmojë, se ato vise janë fikur përgjithmonë.

c) Kufomat e karbonizuar të shqiptarëve dhe shtëpitë e bëra shkruamb e hi të shkaktojnë trishtim vdekjeprurës.

ç) Botës t'i themi: Po i vrasim shqiptarët, se po na detyrojnë.

d) Toka e Shën Savës duhet të hakmeret, shqiptarët i pastron vetëm se thika.

Tash së fundi një praktikë e njëjtë na

u përsërit, edhe nga pasardhsit e tij, Tomisllav Nikoliqit (Toma Grobarit) e Ivica Daçiqit në Luginë të Preshevës, duke e eliminuar lapidarit e dëshmorëve të UÇPMB-së dhe arrestuar ish-ushtarët e UÇPMB'së, pastaj prania e ushtrisë dhe xhandarmerisë serbe dëshmon se qeveria e Beogradit pas protestave gjithpopullore në Luginë të Preshevës, nuk është ndërgjegjësuar aspak, që t'i rrespektojë shqiptarët, se ajo ende punon me metodat e vjetra mitomane dhe piromane. Pastaj ushtria serbe e ka ndërtuar para shumë kohe një bazë ushtarake prej 1000 shtretërve në Borovc të Bujanocit, dhe sipas Agjencisë së Lajmeve TANJ'ug, tanket T-80, janë dërguar me kohë në Rusi për t'u sofistikuar. Këtë e pati dëshmur edhe Nebojsa Çoviqi, kur pati deklaruar se prania e forcave policoro-ushtarake është që të mbrohet popullata serbe nga pjesa e Anamoravës.

Taktika e SANA'së serbe është si zakonisht "pushto, mashtro, asimilo e sërish pushto" nga Beogradi tani krejtësisht është e qartë! Por edhe më i qartë është prononcimi i ish-presidentit Boris Tadiqit dhe klikës së tij shoveniste, se edhe pas opinionit të drejtë të GJND'së, kërkoi bisedime të reja rreth statusit të zgjidhur të Kosovës. Gjer më tani për çfar u bë realitet nga kryeministri i Kosovës H. Thaçi dhe atij serb I. Daçiç me ndërmjetësuesen evropiane baroneshën C. Ashton. Kërkojmë urgjentisht nga faktori i jashtëm dhe ai i mbrendshëm, që kësaj situatë kolonialiste serbe t'i jepet fund në Luginë të Preshevës, se neve shqiptarëve po na kërcnohet ardhmëria jonë etnike, ne mund t'a pësojmë keq, në të njëjtën mënyrë si vëllezërit tanë muhaxhirë, të cilët u zhvendosën barbarisht, nga ushtria piromane dhe vrasëtare serbe nga trojet e Shqipërisë së Vjetër Verilindore si nga: - Toplica, - Nishi, - Piroti, - Negotini, - Zajçari, - Prokupja, - Kurshumlia, - Leskoci, - Vraja... e te tjere.

Ne, shqiptarët e Luginës së Preshevës, për fatin tonë të hidhur nën kolonializmin dhe hegjemonizmin serb, kemi vendosur vet me referendum gjithëpopullor më 1 dhe 2 mars 1992, dhe për ta vulosur më pastaj këtë plebiashit gjithëpopullor me gjakun e derdhur të bijve tanë dëshmor të UÇPMB'së në të tria komunat tona shqiptare të Shqipërisë së Vjetër Verilindore si në: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. E jo sot disa të vetshpallur përfaqësues partiak të sojtit dhe të sorollapit - millosheviqian e çubrilloviqian që manipulojnë me fatin tragjik dhe dramatik të kësaj popullate të përvuajtur shqiptare në tria komunat tona shqiptare. Në fund sa herë që të tjerët kanë vendosur për fatin tonë, ne shqiptarët gjithmonë e kemi pësuar shumë keq dhe është dashur që të derdeshin pastaj lumej gjaku për të drejtat tona legjitime, edhe atë gjatë tërë historisë sonë të lavdishme, këtë jo që po e them unë si një ish i burgosur i ndërgjegjës shqiptarë, por për këtë flet një det i tërë argumentesh dhe faktesh të pakontestueshme historiko diplomatike.

Rroftë Populli Shqiptar! Lavdi dëshmorëve të Kombit!

*) Autori është ish i burgosur politik dhe aktualisht kryetar i "Shoqatës së Muhaxhirëve të Preshevës"

Ndahet nga jeta misionari i pajtimeve te paqes Kol Lulash Bala Fiku

Për komunitetin dukagjinas Kol Lulash Fiku është njohur se, rrjedh nga një familje me tradita të larta patriotike. Ka lindur në fshatin Palaj të komune se Shoshtit, me 15 janar 1933. Mesimet e para i mori në fshatin e tij të lindjes nga Pater Silvester Hila. Në vitin 1946 për shkak se, baba i tij



kundershtoj sistemin komunist, forcat e ndjekes i dogjen shtepin dhe e internuan familjarisht. Kola ne kete kohe ishte ne moshen 13 vjecare. Por, Kola me baben e tij, Lulash Bala e kundershtojne internimin dhe dalim ne mal. Sistemi komuniste e denojen baben e tij me 18 vjete burge, duke e pesuar edhe Kola, i cili ne vitin 1975 u denua me 18 vjet burg. Gjate vuajtjes se denimit i vdesin prinderit dhe djali 16 vjecar, te cilini nuk arriti ti varoste. Pas daljes nga burgu, ne vitin 1989 Kola u angazhua ne misionin e pajtimeve te gjaqeve duke dhene nje kontribute te rendesishem ne pajtimin e tyre dhe zgjidhjen e konflikteve shume te medha te akumuluar neper fshatrat e Dukagjinit. Mori inisiativa te shumta ne ndertimin e kishes previzore ne fshatin Palaj si dhe riparimin e varrezave. Duke bashkepunuar me At' Zef Pllumbi ralizoj meshen e para pas mbylljes se kishave. Fale kembnguljeses se tij dhe Gjelosh Nosh Prognit, beri qindra kerkesa ne bashki, prefektur, ministri qe rajoni nr. 5 te kete emrin "Mark Lula" si dhe mjaftte emra rrugeshe ne qytetin e Shkodres. Deri ditet e fundit te jetes se tij nuk rreshti duke ndihmuar njerzit ne parandalimin e konflikteve kudo qe dilnin.

Keshtu te afermit humben te dashurim e tyre dhe shoqeria nje njeri te perkushtuar per paqe.

Pergatiti ZEF NIKA

POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI

POEZI TE POETIT
FREDERIK RESHPJA

Shqipni

... Tue ngjite malet e
shekujve të tu,
i rropose të gjitha:
Hyjnitë e lashte,
Shtatoret e pluhunosuna,
Mëshirën e ungjijve.

Dhe mbajte vetëm shpatën ...
Vërtet
Ti, ndryshe
Si do të çaje udhe?

Në fushat dimnore

Dëborë e thinjun përulet
Si bard plak mbi telat e mpinë,
Tutje fushës shtyllat trishtohen
Për sa ndamje që mbartin në hapësine.

Ti ke qene në këto fusha me mue,
Ke këpute lule buze udhe dikur;
Due t'i zbuloj gjithë fushat nga dëborë
Të me kujtohesht ti
Me lule nder duer.

Do me kujtohet dhe kënga e vjetër
Qe këndova për ty
Ktu një nate;
Ja, dëborë e thinjun po u bie
Sa bard plak, telave të gjate ...

Poezi Lirike

Po ik nga bregdeti

Nder mend i kam ende
Portokallet që më ngjajnë me yjet e verës.
Tani, lamtumire!
Nën këto mijëra drita të vogla që i lëkund era
në muzg
Mbledh motivet ajrore të rivierës.

Ujna të qeta, të dashura mu si kange himarjote,
U dëgjoj që dallgëzoni brenda meje si ujëvare.

Po niset autobusi.
Portokalle, digjuni mbi mue!
Gjithë peizazhi rrotull rend në dritare.

De Rada

Perse te vene ne det,
Mendimet, zemra ime?
"Milosao"

Po vjen lehte plaku ndanë detit ...
I zbardhun,
I bukur
Si një kangjele shfaqet mes mbrëmjes.
Dhe ngadalë, mbi fushën e gjelbër, ujore
Ku lulëzojnë mijëra yje te ndritshëm,
Rrëshqet kanga e lashte: Do vije dita e Arbërit!

Fryni era e detit, rrezoi hijet e gjetheve të lisit
E hana ndriçoi
Katundet arbereshe dhe gjithë ç' janë mbi dhe.
Ai ecën ndanë detit, plak dhe i zbardhun
E kanga plote shprese dhe drite: Do vije dita e
Arbërit

Sikur hap një dritare tutje ne horizont.
Fluturoi kjo kange si çajke, lart, sipër kohnash.

Vetëm plaku mbet atje ndanë detit,
Ndanë zhurmave te katërta dhe rrokupujes
së valëve;

Ndanë kohnave plot tallaze dhe rrëmujë.
I bardhe dhe i bukur si një kangjele
Shkëlqen ai nën fjalët: Erdhi dita e Arbërit!

Kur vërshojnë përrenjtë

Kur vërshojnë përrenjtë, rendin maleve qiejt,
Pishat e gjelbra ngrihen nder kaltërsitë.
Kur vërshojnë përrenjtë, dallge ngre frymëzimi
Dhe tendosin velat, mes dallgësh,
Meloditë.

... Siluetat e bardha te kullave ecin brigjeve;
Rreke ujnat zbresin ngadalë
Dhe derdhen tingujt malore nga lartësia
Ne vorbullat e kaltra
Të kangeve të mija,

Kur vërshojnë përrenjtë ...

Lokja

Erdhe dhe ti në gjyqin e madh popullor
Me supet e ramë nga udhët e gjata dhe vitet,
Me flokët e zbardhun nga debornat e moteve,
Erdhe dhe u ule mes nesh
E lodhun
Si nga një udhe e gjate.

Thuhej dhe gjëmonte në ndërgegjen tande bota e vjetër.
Ulurinin shenjtoret se deshën të të mbanin.
Tingujt e kambanave lëshonin alarmin;
Dhe ngriheshin kampanjelat e mbështjellë në muzg;
legjendat dhe pallavrat me konstrukt
të çuditshëm të friksonin.

Po ti u kape pas nesh.
Nga fitorja sytë të shkëlqenin.
Shamia e zeze përmbi supe të ra.

Nga libri me poezi
"Rapsodi shqiptare",
botim i vitit 1968

Kurore dëshmoreve

Ve zërin tim të bërë kurorë
dhe dëgjoj erën që jehon nëpër fjalët e mia, që befas u bënë
të gjelbra;
dhe dëgjoj hapat tuaja përmes vjeshtës madhështore;
dhe dëgjoj zërin tuaj ne sfond grykash dhe stuhish,
zërin tuaj, qe kalon mbi relievit e ditëve.

Nuk ju harrojmë!
Sepse koha mes nesh është transparente si ajri.

Zërin tim të bërë kurorë,
zërin tim, që në gjuhë ka rënë,
po vë mbi mermerin tuaj!

Në këtë qytet

- për Shkodrën ku kam lindur -

Unë nuk këndova kurrë për ty.
Mbase nuk kam qenë i sigurt
se zëri im mund të merrte formën e mbrëmjeve,
formën e plazhit ngjyre hënë, që, i lodhur nga zhurmat e ditës,
fle të këmbët e liqenit;
mbase zëri im nuk mund të merrte formën e fluturimit të
pelikanëve,
formën e gjërave të thjeshta si dashuria.

Ndofta zërit tim i mungonin ngjyrat
për të pikturuar lumturinë e udhëve, shiun, kalimtarët.
Si një piktori varfër kam qenë përpara teje!

O

Qytet i dashur!
Sa herë që kam thirrur poezinë nën dyert e tua
dhe kam mbledhur ngjyra nën ajrin tënd plot dritë, si piktorët,
unë vetëm këtë kam dashur:

nëpër penelatat e zërit tim të shfaqeshin konturet e tua,
tërbimi i kësaj qenjeje të gurtë, që vërtitej mbi hordhitë e
Alarikut,
trokëllimat e perandorëve të mundur, mbi udhët e ngrëna nga
kuajt
dhe çatitë e larta si mijëra harqe triumfi;
Lumbeti 1) havanat, dhembja e ahengxhinjve;
Qe te ngrihej Haliti nga kënga e tij, si nga një pellg gjaku
Me gjithë dashurinë e tij të madhe dhe fatale.

O

Dua të them që dashuria ime i ka rrënjët në vjeshtat e tua,
Kur bie dritë e verdhë gjethesh
dhe lëkundet degët e shirave;
që gravura jote më rri e varur në shpirt,
gravura jote ngritur gurë-gurë mbi sytë e bukur të Rozafës.
O, me merr malli për vjeshtën tende, për gurët!
Kur jam larg teje
më merr malli për këngët që këndojnë erërat e tua netve.

O

Në këtë qytet, që agoi mes zërit tim,
banon e dashura ime;
e dashura ime i ka sytë në ngjyrën e qiellit (në momentin e
perëndimit).
Sikur sytë e saj kanë dalë nga ky moment,
nga ky moment i prerë prej shelgjeve që u ka rënë muzgu për-
sipër.

O

E dua këtë qytet
me lagjet e vjetra, ku u ra këmbanave të poezisë Migjeni.
Zëri i tij prej bronci çante si avion modern mbi kurrizet e po-
emave të vjetra dhe të hutuara..
Për ku po ikën kështu?
Pyesnin poetet ciceronjës nga selvitë
duke vështruar fluturimin e çuditshëm të zërit te tij.
Ai ikte.
Si një avion i vetmuar nën hënë.
Ulërima madhështore çante horizontin e kohës.

O

Qytet i dashur!
Këndoj themelet e tua që u hapen mes legjendës,
shekujt që kalëruan mbi këto kalldrëme,
duke përcjelle drejt kohës heroizmin,
dhe atë ilegalin, që vuri të parin trakt.
Trakti ndriçonte, sikur u elektrifikua qyteti i fenerëve.

O

U derdh kaq gjak.
Trojet e tua duhej të ishin të kuqe,
trojet e tua, ku kaloi Manushi,
me këmbësorë e kuqe, si një copë betejë hedhur supeve.
Kur hapeshin sytë e tij,
ngrihej Ylli i Karvanit mbi dhembjen e botës.
Kalonte mes lagjes së varfër,
sikur sillte me vete agimin që bie mbi livadhe.

O

Qytet i dashur! Kam dashur gjithnjë që me zërin tim
të ngre një kënge, ku të depërtohen uzinat e tua
si nëpër godinat transparente moderne;

FAMILJA LEKE CURRI

Si kudo në Shqipëri edhe ne Theth të krahines se Shalës në Dukagjin, ka patur me dhjetra familje të njohura që kanë bërë emer. Fjalën e kemi për familjen Lekë Curi, ne Theth. Familje, me tradita patriotike e atdhetare të tasheguara brez pas brezi. Por kryefjala e kësaj familje ka qënë burrëria, besa e trimëria. Respekti për këtë familje ka qënë jo vetëm i banorëve te Thethit e te Shalës, madje shkonë në gjithë Dukagjinin, Malësin e Madhe e deri ne Malësinë e Gjakovës. Kjo familje krahas vertyteve të tjera të larta ka pasur edhe etjen për shkollë e dije.

Me sakrificë të medha, Mark Prela mbarojë shkollën për teologji me rezultate të shkëlqyera e u diplomua për frat. Karrierën e filloj në zonën e Pultit, në Dioqezën e Pultit. Ndonse i përkete vitit 1948, emri i At' Daniel Gjeçajt lakohe për mirë, i cili predikojë krahas fesë edhe atdhedashurinë për vendin. Sulmit kunder fesë dhe klerikëve në pëgjithësi, e atij katolik në veçanti, nuk i shpëtojë as At' Daniel Gjeçaj, të cilin sigurimi i Shtetit e vuri në shenjestrën e tij. Në vitin 1948, pasi thirret disa herë në postin e policisë dhe i kerkohej të spiunonte shokët e tij famullitar, pra të bëhej bashkëpunëtor i sigurimit, ofertë të cilën e refuzojë me neveri. Informohet se, do ta arrestonin në mbledhjen e zonës së Pultit, merrë leje në lëshim për të shkuar pranë familjes. Ecen për rreth 8 orë në këmbë dhe arrinë në Theth. Pasi shkon në familje e perqafohet me të gjithë u thotë se, nuk do të shihemi për disa muaj, por kjo zgjat plotë 45 vjet! Në Theth takohet me një shok të fëmijërisë, me Kole Leken dhe e vendosin të largohen nga Shqipëria, nisen për Rrogam të Shalës. Pasi hëngren darkë, moren bukë me vete, kaluan qafën e Valbones dhe qendruan disa ditë në Rrogam. As këtu, nuk i shpëtojë spiuneve të sigurimit, por për arsye etike nuk po i permendi as bukë dhënsin as spiunin. Pas qendrimit në Rrogam, bashke me mikun e shtëpisë Nikë Sokolin e Kolë Lekën aratisën në Jugosllavi.

Megjithse fizikisht At Daniel Gjeçaj shpëtojë, por moralisht vuajti tërë jetën, duke e ditur se çfarë po vuante familja e të afermit e farë e fisi. Si rrjedhojë me një herë familjes s'tij i konfiskojnë gjithë pasurinë, madje edhe shtëpinë e banimit ja kthejne ne konvikt, e titullojnë me emrin konvikti "Tomë Kola", për disa vite. Edhe, pse konvikti transferohet në Shkoder, shtëpinë nuk ia kthejne, por ne te vendosin postën e policisë. Kjo familje vijon te strehohet nëpër kasollet e fshatit, është detyruar te dimrojnë në stanet e bjeshkes, ku minimalisht binte mbi 2 meter borë, në bjeshkën e Praçës, minimalisht 2 ore larg fshatit.

Duke mos u mjaftuar me këto reprezalje, familja e Lekë Curit internohet në kampin famkeq të Tepelenesë në kushte të pa imagjinueshme. Për t' i mposhtur psikologjikisht edhe në Tepelene nuk i lënë, por menjëherë i transferojnë në kampin tjetër të internimit, në Berat. Me sa duket nuk ju mjaftonte interinimi, menjëherë arrestojnë Lucë Prelen, pa asnjë arsye, vetem se ishte i vllaj i At' Daniel Gjeçajt. Aktiviteti i fratit në Vatikan, duke qënë Drejtori i radio Vatikanit dhe programuesi e folsi i kësaj radio në gjuhën Shqipe, ua errësojë syt regjimit, të cilët e dinin se ky emision ndiqesh në Shqipëri nga mijra e mijra persona. Në të njëjtën kohë At' Danieli ishte edhe kryetar i emigracionit Shqiptar në botë. Nuk ishte rastësi si një djali i familjes se Lekë Curit të bëhej i njohur në Europën Prendimore, për propogandën kundër komunizmit. At' Zef Pllumi e quajti si teolog, ideolog dhe politikan eurodit, te ky frat ishin mëshiruar vertytet të mahnitshme, siç i ka Thethi ku lindi.

Aktiviteti intensiv i At' Danielit, rëndojë përsëri mbi familjen e tij, në vitin 1961, perseri familja e Lucë Prelës internohet, po tani jo në Tepelene e as në Berat, por në Lushnje, për të qendruar për 10 vjet në kënetat e këtyre fshatrave. Duke intensifikuar më tej presionin psikologjik e rrenimin ekonomik, edhe ne internim nuk e dergojnë gjithë familjen, po i nda-



At Daniel Gjeçaj

jnë, duke internuar Lucë Prelen me djalin Gjëloshin e nuse Pashkën të sapo martuar; ndersa Rozë Gjekja me vajzat i lanë në Theth. Kjo nuk bëhej për mëshirë, por për presion psikologjik. Burrneshe Roza, si bijë e Malësisë së Madhe, ndonse me fukarallek të madh, diji t' i rrisë, t' i edukojë e ti martojë me nder në familje të nderuara. Ashtu, si për mijëra familje në Shqipëri, edhe për këtë familje erdhi shpresa e shpëtimit, pra hyri demokracia e ku këto familje po zinin vendin që meritonin.

Gjëlosh Luca, me gjithë vuajtjet e shumta të jepë përshtypjen e një 45 vjeçari, ndonse i ka kaluar të 70 vjetet. Në fëtyrën e tij rrezaton fisnikëri e kulturë. Në biseda e siper ai, tregonë me modesti se vuajtjet i kamë përballue falë familjes sime, e veçanarisht të bashkshortes Pashka, e cila më ka mbështetur në të gjitha aspektet e jetës. Djemte e Gjëloshit jetojnë,

ndersa tjetri ka një biznes turistik në Theth, ku nuk ka kuptim vajtja në Theth pa frekuantuar këtë Bar-Restaurant-Hotel, i cili jua kalon edhe atyre në qytete moderne, me ambiente shlodhese e relaksi, si kënde lojrash, parking e te tjera dhe mbi të gjitha sherbimi i kulturuar ne këto ambiente mahnitse.

Po diçka të bënë përshtypje, si nuk u kujtua as pushteti vendor e as ai qendror, që t' i japin vendin e merituar kësaj familje të nderuar. Nuk respektuan asnjë pjestar të kësaj familje, të cilët qendruan pa u ligështue përballë diktaturës!? At' Daniel Gjeçaj, Lekë Curi e Lucë Prela qendrojnë në nderin e nacionalitetit, pa varësisht se, pa letra. Mendojë se pushteti vendor duhet t' i bëj qytetar nderi të Komunës Shalë. E pse jo ti propozojnë Presidentit të Republikës që tu akordojë tituj e medalje të tjera nderi.

Nga Ndue ZIÇI

dit' e natë të zhurmonin urbanet të kryet e poemës.
Dit'e natë të vërtiteshin agregatët e rëndë;

të dëgjoja vërsëllimën e ajrit nëpër rreshta,
mbuluar nga qielli plot tym,
dhe rreth meje dhe brenda meje të ndjeja forcën e hekurt.

Në thellësi të zërit tim unë e dëgjoj ushtimën tënde,
si ushtimën e largët të njeriut që kam më të dashur ...
Po kështu më ngjet gjithnjë:
Figura jote lëviz, si një portret që s'e kapin dot penelet
dhe para meje telajua e poemës mbetet e bardhë.
1) Lembe – anije ilire

Devolli

Toka e ngarkuar me fruta dhe drith
ecën drejt muzgut. Mbi mullarët,
si një gizar, hëna doli
dhe nga fshati tutje varet një gajde,
si zëri popullor i Dritero Agollit.

Devolli! Kam dashur prej kohe të vij këtu,
të këndoj mes zërin tim verior
nëpër fushat e tua të gjera;
tani jam si një tenor i lumtur që befas e kanë ftuar
në një skene madhështore.

Dajçi në Breg të Bunës

Gazi i bregut plot fëmije.
Madhështia e ujërave të kaltra, ngarkuar me peizazhe plot
drurë.
Vajzat dhe rëra.
Tutje lundrojnë peshkatarët.
Gazi i vajzave i ndjek pas një tufe pulëbardha.

Ja, aty në breg është Dajçi i vjetër dhe i bukur,
që duket mbrëmjeve si një katund yjesh, si një katund yjesh,
i ndërtuar në breg të kaltërsive.

Dje erdhi e dashura të më shihte mua
dhe grunjat përkuleshin si arlekinë të gëzuar rreth vajzës nga

qyteti,
dhe dolën kooperativistët të shihnin të dashurën time,
dhe peshkatarët tërhiqnin rrjetat ne breg.

Ajo shkoi në mbrëmje.
Pikërisht kur hëna ngre një urë mes dy brigjeve,
kur mjergullat ulin krahët mbi lume, kur fshati duket si një
katund yjesh i ndërtuar në breg të mjergullave, kur fëmijët ikin
të flenë dhe ndërpritet e qeshura në bregdet,
kur vajzat u pëshpërisin të dashurave në korie.

Desha të thosha që unë e dua këtë fshat të argjendhtë,
me grunjat, me hënën, me dashuritë, këtë desha të thosha.

Marrë nga libri
"Në këtë qytet vjersha dhe poema",
botim i vitit 1973

KUSH NUK BESON NË ÇUDIRA NUK ËSHTË REALIST


Ky postulat na vjen nga lashtësia greko-romane. Degën për here në lulëzim të ullirit greket e lashte e vinin mbi kokën e fitimtareve në lojërat Olimprike, dhe mbi kokën e autoreve dhe aktoreve në festat dioniziake. Bleta dhe ulliri e çuditen aq shume Virgjilin e madh të "Eneides" sa ai u thuri atyre poema e ditirambe. Ndërsa në mesjetën e hershme, kur botën e infektuan ethet e arit, alkimistet, në kërkim të gurit filozofik që do kthejë çdo metal në ar, gërmuan në thellësitë e nënës natyre dhe "për çudi" u bënë zbulues të sa e sa elementeve të reja fizike dhe kimike, që u bene baze dhe strehe e zbulimeve shkencore, që e bene më të bukur dhe më të volitshme jetën njerëzore.

A nuk përben një çudi edhe vete qenia jone, specia njerëzore, kur edhe sot na e gërmon trurin pyetja se, nga vijmë dhe a jemi unikal në të stërmadhin Univers?

Mes dhjetëra e mijëra nxënësve dhe studenteve që pata fatin t'u jap mësim gjate profesionit tim si mësues e pedagog, Muhamet Trepçi spikaste si enigmatik, që të shikonte në sy pa folur asnjë fjale, që, "blinte" dhe nuk "shiste" deri në atë pike sa të vinte në prove durimin kur ballafaqohe me te. Sot është inxhinier elektrik, por ka dhe një profesion tjetër, atë të zdrukthuarit, marangozit që ia imponuan, kur mori maturën, fale biografisë "me hije". Ky profesion, u bë një hobi që i hyri thelle në shpirt sa edhe sot e kësaj dite e tërheq fort. E tërheq druri, e sidomos ulliri. Ai, si të thuash, iu fal ullirit, gër-

moi në thellësitë mijëravjeçare të tij, dhe ai, ulliri e shpërbleu, duke i hapur shpirtin mijëravjeçar. Ulliri i shfaqti enigmën e tij "enigmatikut" Muhamet Trepçi. Dhe, duke perifrazuar emrin e ish nxënësit tim, ai, si të thuash beri realitet proverbin e famshëm "... nëse nuk shkon Muha-

meti tek mali, vjen mali tek Muhameti". Dhe, "mali", çudia e nënës së çuditshme natyre i shfaqti Muhametit mrekullinë e ullirit, vetinë fotografuese të tij, vetinë dokumentare të shekujve që ai përjeton. Ne kemi dëgjuar për vetinë e celuloidit të drurit të arrës, që fotografon në trupin e tij gjallesat që i rrinë pranë, por këtë dhurate hyjnore të ullirit, për të parën here na e zbulon Muhameti. Për të parën here, ndoshta në gjithë botën. Dhe, nuk ke si të mos ndjesh krenari, kur mendon se zbuluesi është një shkodran ... Duke e prere drurin e ullirit, ai zbuloi fotografime në mënyre





fantastike të zogjve, qenieve njerëzore, gjarpërinjve, siluetae enigmatike ... mbi tridhjetë të tilla. I sheh në shtëpinë e tij si muze dhe çuditësh ... sepse flasin vete ... dhe të bëjnë të besosh, ty, ... realistit, mosbesuesit.

- Unë zgjedh trungjet e ullinjve me vraga dhe me gunga. Ata i pres dhe ata më dhurojnë historinë e tyre, - thotë Muhameti dhe është ndoshta fraza më e gjate që shqipton gjate takimit me te.

- Vraga ... gunga ... Rrufetë dhe zemërimet e motit. A nuk i provojmë edhe ne, njerëzit gjate rrugëtimit tone drejt vdekjes ... rrugëtim që quhet jete? A nuk shkaktajnë dhimbje dhe brenga ata? Dhimbje dhe brenga që i ruan përbrenda gjithë jetën! Nuk bën përjashtim as ulliri. Me dhimbje i fotografon dhe i ruan përbrenda jo aq sa vitet e jetës njerëzore, por me shume ... me mijëra të tilla.

- Dhe ja tek kthehemi në titullin e këtij shkrimi. Realisti duhet të besojë tek çudirat. Sepse, Muhamet Trepçi, duke të dhuruar një copëz druri ulliri në forme relike, ku është fotografuar një zog prehistorik, një siluete gruaje apo një gjarpër, ty

VITRINA E LIBRIT



të duket se të ka dhuruar një talisman që duhet ta vesh në qafe për të mos harruar vragat dhe gungat, rrufetë dhe shkrepimat e motit që do provosh në jete, dhe do t'i fotografosh, siç bën blici i aparatit tënd fotografik.

- Ka botuar një libër Muhameti, me titull "Me emocionet e nënës natyre". E ka botuar në tri gjuhë, shqip, anglisht dhe italisht. Për ekspozitat e Muhametit kane hapur dyert muzetë e Romes apo të Budves dhe është shkruar me pavagjerizem për këto ekspozita. Për "çudi", në Shqipëri, as në Shkodër nuk është hapur asnjë e tille! Dhe unë pyes-Perse duhet t'i qëndrojmë atij proverbi bajat se, "Në katundin tënd, nuk bëhesh kurrë pashe"? Mjeshtër **FADIL KRAJA**

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Drita Shyti, Roza Pjetri,
Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja,
Zef Nika,
Florenc Buxha, Lulash Brigja